



Финансирано од
Европска Унија



ANALIZË E GJENDJES SË DHUNËS KIBERNETIKE ME BAZË GJINORE



Studiuese: Mr. Liljana Pecova-Ilieska.

Mohim i përgjegjesisë

Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Iniciativës për Perspektivë Evropiane / Gratë e reja kundër dhunës në online] dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për asnjë përdorim të informacionit që është i përfshirë këtu.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Gratë e Reja Kundër Dhunës Online”, i zbatuar nga Iniciativa për Perspektivë Evropiane në partneritet me Vlerat e Përbashkëta, i bashkë-financuar nga BE-ja.

SHKUP
Mars 2025

Përmbajtja

Hyrje	3
Terminologjia	4
Dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia (DhBGj LT)	4
Kuptimi i formave të ndryshme të dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave (DhGV LT)	5
Metodologjia.....	7
Korniza rregullatore	7
Legjislacioni ndërkombëtar.....	7
Legjislacioni kombëtar.....	10
Rastet dhe ndikimi në legjislacion	14
Baza e të dhënave të aktorëve kryesorë	16
Gjetjet e anketës	17
Anketë për aktivistët e shoqërisë civile mbi dhunën kibernetike me bazë gjinore ndaj grave të reja	17
Anketë për psikologët/punonjësit socialë e aktivistëve të shoqërisë civile mbi dhunën kibernetike me bazë gjinore ndaj grave të reja	30
Përfundime	46
Rekomandime	47
Referencat	50

Hyrje

Luftimi i dhunës kibernetike me bazë gjinore

Interneti e ka transformuar plotësisht mënyrën se si punojmë, blejmë, mësojmë dhe komunikojmë, duke u integruar në pothuajse çdo aspekt të jetës së përditshme. Megjithatë, përveç këtyre përfitimeve, ai është bërë edhe një mjet për të shprehur emocione negative si p.sh. zemërimi dhe frustrimi, madje edhe për të ushtruar kontroll ose për të shkakuar dëm. Ashtu sikurse format tradicionale të keqpërdorimit dhe krimit, edhe keqpërdorimi kibernetik mund të shkaktojë përvoja thellësisht të pakëndshme dhe traumatike për viktimat¹.

Jetojmë në një epokë kur komunikimet digjitale po zhvillohen me një shpejtësi të jashtëzakonshme, duke e bërë gjithçka, kudo dhe për të gjithë shumë më të arritshme. Megjithatë, përkundër përfitimeve të mëdha në fushat e rrjetëzimit, shkëmbimit të informacionit dhe lirisë së shprehjes, këto platforma keqpërdoren gjithnjë e më shumë për çdo ditë dhe janë bërë vende ku kërcënimet dhe dhuna kibernetike janë në rritje. Gjithmonë ekziston një vijë e hollë ndarëse midis asaj se çfarë përbën një kërcënim offline dhe atij online. Është e qartë se legjislacioni në nivel global po ndryshon ngadalë dhe nuk po ecën në hap me progresin teknologjik.

Hulumtimet tregojnë se grupet e cënueshme, veçanërisht gratë dhe fëmijët, janë viktimat më të shpeshta të kërcënimeve kibernetike. Pasojat janë të gjera, duke përfshirë ndikime psikologjike dhe emocionale, ulje të cilësisë së jetës dhe efekte mbi procesin arsimor dhe karrierat profesionale të viktimave. Kërcënimet kibernetike dhe dhuna kibernetike nuk mund të konsiderohen si çështje të ndara, pasi teknologjia e TIK-ut është e integruar në të gjitha sferat e jetës së përditshme, dhe si rezultat i kësaj edhe kërcënimet kibernetike janë gjithnjë e më të pranishme, me ç'rast dhuna kibernetike ka pasoja të ndryshme dhe të gjera, si të menjëhershme ashtu edhe afatgjata, që ndikojnë në jetën e ardhshme të viktimave. Kjo krijon nevojën për të përcaktuar në mënyrë të qartë termat dhe për të bërë një dallim të qartë midis asaj se çfarë është, e çfarë nuk është një kërcënim kibernetik. Për pasojë, duhet të identifikohen llojet e ndryshme të kërcënimeve kibernetike që shfaqen për çdo ditë, duke përfshirë edhe (dhunën ndaj grave dhe vajzave të lehtësuara nga teknologjia (DhGV LT), e cila kryhet me ndihmën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK).

Gjinia është një nga faktorët kryesorë në sigurinë kibernetike ndërkombëtare. Integrimi i perspektivës gjinore në politikat e sigurisë kibernetike është me rëndësi kyçe për të kuptuar dhe adresuar në mënyrë të drejtë rreziqet dhe nevojat e ndryshme me të cilat përballen temat e ndërlukuara. Me një qasje të drejtë gjinore ndaj praktikave dhe politikave të sigurisë kibernetike, kornizat ligjore do të jenë gjithëpërfshirëse dhe të hartuara për t'i mbrojtur të gjithë, veçanërisht gratë dhe vajzat që janë në shënjestër të kërcënimeve kibernetike në një shkallë më të lartë se të tjerët. Në nivel ndërkombëtar, politikat dhe masat globale kanë shënuar përparim, por ende ekzistojnë shumë boshllëqe në lidhje me koordinimin e mirë dhe përkufizimet e qarta ligjore të

¹ Vakhitova, Zarina dhe Alston-Knox, Clair dhe Reeves, Ellen dhe Mawby, R. (2021). Shpjegimi i ndikimit ndaj viktimave nga abuzimi kibernetik: Analizë hulumtuese me metoda të kombinuara. Sjellja devijante. 43. 1-20.
10.1080/01639625.2021.1921558. Linku:

https://www.researchgate.net/publication/352260407_Explaining_Victim_Impact_from_Cyber_Abuse_An_Exploratory_Mixed_Methods_Analysis

termave dhe të masave që duhen të ndërmerren për të adresuar kërcënimet kibernetike ndaj grave dhe vajzave.²

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, kërcënimet kibernetike ndaj grave dhe vajzave janë të lidhura ngushtë me normat patriarkale që ende ekzistojnë. Kërcënimet online në Ballkan nuk janë neutrale në aspekt gjinor dhe mund të thuhet se gratë dhe vajzat janë shumë më shpesh në shënjestër dhe viktime të dhunës kibernetike. Për më tepër, ky raport shqyrton boshllëqet kritike në legjislacion dhe në zbatimin e tij, duke pasur parasysh se kërcënimet kibernetike ndaj grave dhe vajzave janë në rritje të shpejtë dhe po bëhen gjithnjë e më të përhapura si në nivel global ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, propozohen disa rekomandime dhe masa efektive për të mbrojtur gratë dhe vajzat në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim të forcimit të strategjive dhe plotësimit të mbrojtjes ligjore, me qëllimin të vetëm për të krijuar një mjedis më të sigurt online që i njeh dhe mbron të drejtat e tyre.

Terminologjia

Dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia (DhBGj LT)

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj), i prek ndjeshëm tek gratë dhe vajzat, duke ndikuar në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, mirëqenien, sigurinë dhe reputacionin e tyre. Edhe pse dhuna e lehtësuar nga teknologjia nuk është gjithmonë me bazë gjinore, të dhënat dhe përvojat e të mbijetuarve sugjerojnë se gratë dhe vajzat preken në mënyrë disproporcionale. Nuk ka një përkufizim të pranuar universalisht të DhBGj-së, megjithëse organizata të ndryshme ndërkombëtare ofrojnë interpretime të ndryshme. Duke e njohur këtë boshllëk, UN Women, si pjesë e një programi të përbashkët për mbledhjen e të dhënave, mbledhi një grup ekspertësh që propozuan përkufizimin e mëposhtëm:

Dhuna ndaj grave e lehtësuar nga teknologjia (DhNG LT) përfshin çdo akt që kryhet, lehtësohet ose përkeqësohet nga mjetet digjitale, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), që shkakton ose mund të shkaktojë dëm fizik, seksual, psikologjik, social ose ekonomik, apo që i shkel të drejtat dhe liritë.

Grupi i ekspertëve gjithashtu sugjeroi që termi **“Dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia (DhBGj LT)”** mund të përdoret në mënyrë të ndërsjellë me termin DhNG LT), pasi përkufizimi më i gjerë e përfshin të gjithë fenomenin. Ky përkufizim do të shërbejë si udhëzim për këtë projekt.

Në nivel ndërkombëtar, theks gjithnjë e më i madh i vendoset nevojës për një përgjigje efektive përmes legjislacionit penal në adresimin e DhBGj LT-së.

Në vitin 2018, Raportuesi Special i OKB-së për dhunën ndaj grave e theksoi nevojën për të kriminalizuar dhunën e lehtësuar nga teknologjia, në mënyrë që të sigurohet që viktimat të mund “t’i mbrojnë t’i drejtat e tyre për privatësi dhe dinjitet”. Raportuesi Special theksoi më tej se shtetet duhet të fusin dispozita të reja ligjore ose t’i përshtatin kornizat ekzistuese ligjore, nëse është e nevojshme, për të mundësuar procedura penale dhe civile kundër autorëve. Shtetet duhet **ta ndalojnë dhe ta kriminalizojnë në mënyrë të qartë dhunën digjitale ndaj grave**, duke

² Brown, D., Pytlak, A. (2020). Pse gjinia ka rëndësi në sigurinë kibernetike ndërkombëtare, Linku: <https://assets.kpmg.com/content/dam/kpmgsites/uk/pdf/2023/12/cybersecurity-gender-equality-and-social-inclusion.pdf>

përfshirë **shpërndarjen e fotografive intime pa pëlqimin e tyre, ngacmimin online dhe përndjekjen kibernetike.**³

Në botën e sotme, teknologjia dhe mjetet e komunikimit digjital po zhvillohen me një shpejtësi të jashtëzakonshme, duke mundësuar lidhje, diskutime dhe shkëmbime që më parë ishin të paimagjinueshme. Megjithatë, të njëjtat platforma që ofrojnë qasje të pakufizuar dhe liri të shprehjes, janë bërë edhe hapësira ku kërcënimet digjitale dhe format e dhunës janë gjithnjë e më të zakonshme. Për viktimat, pasojat janë emocionale, sociale dhe ekonomike, duke i detyruar që ndonjëherë t'u shmangen hapësirave të caktuara online. Viktimat mbrohen duke raportuar, duke kërkuar mbështetje ose duke e ndryshuar sjelljen e tyre në internet. Kjo qasje mundëson që problemi të shihet nga një perspektivë më e gjerë, e me këtë edhe mundësitë për t'i zbuluar shkaqet e tij. Kjo çon në një mjedis kibernetik më të sigurt për të gjithë.

Këto pasoja janë shumë serioze sepse kërcënimet online çojnë në dëmtime psikologjike dhe emocionale, shpesh duke i dekurajuar gratë që të inkuadrohen plotësisht në hapësirën digjitale, gjë që, nga ana tjetër, mund t'i kufizojë mundësitë e tyre arsimore dhe profesionale. Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave (DhGV LT) është një problem në rritje, me ç'rast ekzistojnë mënyra të ndryshme për ta shkaktuar atë nga perspektiva teknologjike - nga dezinformimi dhe ngacmimi deri te ngacmimi online, shpërndarja e paautorizuar e fotografive personale dhe gjuha e urrejtjes e rrënjësuar në diskriminimin gjinor. Kjo është arsyeja pse kjo formë relativisht e re e dhunës, por që përhapet me shpejtësi, kërkon vëmendje urgjente dhe masa efektive për t'i mbrojtur personat e cenueshëm online.

Kuptimi i formave të ndryshme të dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave (DhGV LT)

Këshilli i Evropës e përcakton *ngacmimin kibernetik* si një formë serioze të DHGV LT-së, e cila i ka në shënjestër gratë dhe vajzat përmes formave të ndryshme të sjelljeve abuzive. Këto veprime zakonisht kanë formën e mesazheve të padëshiruara me përmbajtje eksplicite seksuale, lajkatimeve në rrjetet sociale dhe platformat e tjera, si dhe kërcënimeve për dhunë fizike ose seksuale. Ngacmimi kibernetik gjithashtu përfshin gjuhën e urrejtjes që synon të fyejë, të poshtërojë ose të frikësojë individët në bazë të gjinisë së tyre ose karakteristikave të tjera, siç janë orientimi seksual ose aftësia e kufizuar. Ky lloj ngacmimi përfshin akte specifike si "maltretim online" dhe "pornografi hakmarrëse", të cilat i kalojnë kufijtë personalë dhe shkaktojnë dëm afatgjatë emocional.

Ngacmimi kibernetik është ndoshta forma më e gjerë e dhunës kibernetike dhe përfshin sjellje të vazhdueshme dhe të përsëritura të drejtuar ndaj një personi specifik, me qëllimin për të shkaktuar shqetësim serioz emocional, e që shpesh herë rezulton edhe në frikë nga lëndimi fizik. Në praktikë, aktet e dhunës kibernetike mund të përfshijnë forma të ndryshme të ngacmimit, shkeljes së privatësisë, abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual, si dhe vepra të urrejtjes nga paragjykimi ndaj grupeve shoqërore ose komuniteteve. (Llojet e dhunës kibernetike, Këshilli i Evropës)

³ A/79/325: Raporti i Raportuesit Special mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, shkaqet dhe pasojat e saj - Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Sport; Linku: <https://www.ohchr.org/en/documents/thematic-reports/a79325-report-special-rapporteur-violence-against-women-and-girls-its>;


Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) e përcakton DhGV LT-si një sërë sulmesh me bazë gjinore të kryera përmes mjeteve digjitale, shpesh të kombinuara me faktorë të tillë si raca, mosha, aftësia e kufizuar, seksualiteti, profesioni ose bindjet. Disa nga këto veprime fillojnë në internet dhe zhvendosen në hapësirat fizike (në punë ose në shtëpi), ndërsa të tjerat fillojnë jashtë internetit dhe më pas vazhdojnë përmes rrjeteve sociale, e-mail-it apo aplikacioneve të mesazheve. Autorët mund të jenë anonimë (të panjohur) për viktimën ose të njohur (ish-partner, shok klase ose koleg). Si Qendër kryesore e Njohurive mbi Barazinë Gjinore në BE, EIGE ofron një kornizë të qartë për t'i kuptuar format më të zakonshme të dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave. (EIGE, 2021) Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) i përshkruan llojet më të zakonshme të dhunës kibernetike me të cilat përballen gratë dhe vajzat, duke e bërë më të lehtë për ta kuptuar se si këto sjellje të dëmshme ndikojnë në jetën e përditshme:

Përndjekja kibernetike: Kjo lloj dhune kibernetike përfshin veprime të vazhdueshme dhe të qëllimshme që synojnë të ngacmojnë, të frikësojnë ose të krijojnë të kontakte të padëshiruara me gratë dhe vajzat. Shpesh e nxitur nga paragjykimet gjinore dhe ndonjëherë e kombinuar me racën, moshën ose faktorë të tjerë, përndjekja kibernetike përdor mjete digjitale për t'i bërë viktimat të ndihen të frikësuara, të kërcënuara ose të pasigurta në jetën e tyre të përditshme.

Ngacmimi kibernetik: Për dallim nga ngacmimi tradicional, ngacmimi kibernetik shtrihet në botën digjitale, ku mund të jetë i pamëshirshëm. Ka shumë raste të ngacmimit, shantazhit, fyerjeve dhe vjedhjes së identitetit që i synojnë drejtpërdrejt gratë dhe vajzat për shkak të gjinisë së tyre, dhe shpesh synojnë aspekte të tjera të identitetit të tyre, siç janë orientimi seksual apo aftësia e kufizuar. Këto sulme kanë për qëllim të izolojnë, turpërojnë dhe dëmtojnë emocionalisht individët, duke i bërë të ndihen të marginalizuar ose të sulmuar.

Gjuha e urrejtjes me bazë gjinore në hapësirën online: Kjo përfshin përmbajtje të urrejtjes ose të dhunës në internet që i synon gratë ose vajzat, shpesh për shkak të gjinisë së tyre ose në kombinim me faktorë të tillë si raca ose feja. Zakonisht e pranishme në platformat publike, kjo lloj përmbajtjeje shpesh i ka në shënjestër gratë në pozicione të larta, duke i paraqitur ato si objekte ose viktimat të dhunës.

Për më tepër, sipas një raporti të UN Women të vitit 2023 (UN WOMEN, 2023), dhuna ndaj grave online merr shumë forma, me ç'rast gjatë hulumtimit të tyre janë theksuar nëntë llojet më të zakonshme. Në fakt, 66% e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia fillon me ngacmim kibernetik. Kjo përfshin kërcënime fizike në internet, mbikëqyrje të padëshiruara, marrjen e fotografive të padëshiruara dhe përjetimin e ngacmimeve të koordinuara nëpër platforma të ndryshme.



Burimi: <https://onlineviolencewomen.eu.com/>

Metodologjia

Ky hulumtim do të përdorë një qasje të kombinuar metodologjike, duke e ndërthurur analizën cilësore dhe sasiore për të shqyrtuar dhunën kibernetike me bazë gjinore. Do të kryhet një **analizë e dokumenteve** për të shqyrtuar ligjet, strategjitë dhe planet ekzistuese të veprimit në lidhje me dhunën ndaj grave, dhunën në familje, ngacmimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, me qëllim të identifikimit të boshllëqeve, mbivendosjeve dhe përputhshmërisë me kornizat ligjore të BE-së dhe ato ndërkombëtare. Do të zhvillohet një **bazë të dhënash e aktorëve kryesorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë** që janë të përfshirë në përpjekjet për parandalim dhe mbrojtje, për të hartëzuar peizazhin institucional.

Për të fituar njohuri të drejtpërdrejta, do të hartohen dhe do të zbatohen **anketa online të bazuara në pyetësorë**, të cilat do t'u dërgohen aktivistëve të shoqërisë civile dhe psikologëve që punojnë me viktimat, me qëllim që të mblidhen informacione rreth përvojave dhe sfidave të tyre. Të dhënat e mbledhura nga anketa do t'i nënshtrohen **analizës sasiore dhe cilësore**, ndërsa rezultatet do të përfshihen në mënyrë sistematike në raportin përfundimtar. Në fund, do të përpilohet një **raport gjithëpërfshirës analitik**, i cili do t'ë sintetizojë rezultatet e analizës së dokumenteve dhe të anketave, për të ofruar rekomandime të bazuara në prova për forcimin e mekanizmave për mbrojtje nga dhuna kibernetike me bazë gjinore.

Korniza rregullatore

Legjislacioni ndërkombëtar

Përpjekjet ndërkombëtare për të adresuar dhunën kibernetike ndaj grave dhe vajzave (DhGV LT) po shënojnë përparim, por ende ekzistojnë boshllëqe për sa i përket koordinimit dhe përkufizimeve të qarta ligjore. Në BE, megjithëse disa rregullore dhe direktiva adresojnë aspekte të caktuara të DhGV LT-së, ende nuk ka një përkufizim të unifikuar ose një kornizë ligjore specifike. Propozimi i ri nga Komisioni Evropian për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, i cili përfshin formë të ndryshme të dhunës kibernetike, paraqet një hap premtues përpara. Komisioni propozoi një Direktivë të re për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje u miratua

më 7 maj **2024 (Direktiva (BE) 2024/1385)**. BE-ja tani ka ligjin e parë për të luftuar në mënyrë efektive dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.⁴ Vendet anëtare të BE-së kanë tre vjet kohë për ta transpozuar Direktivën në legjislacionin e tyre kombëtar. Kjo Direktivë prezanton termin "dhunë kibernetike", por pa ofruar një përkufizim gjithëpërfshirës. Direktiva thekson forma të ndryshme të dhunës kibernetike, duke përfshirë përndjekjen, ngacmimin, shpërndarjen pa pëlqim të fotografive intime dhe nxitjen e dhunës ose urrejtjes në internet. Ajo propozon masa gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, duke u mundësuar atyre të parashtrojnë ankesa online ose përmes teknologjive të sigurta të informacionit dhe komunikimit, veçanërisht për krimet në internet, siç është shpërndarja pa pëlqim e përmbajtjeve intime ose ngacmimi.

Komiteti Këshillimor për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat rekomandon përdorimin e termit "dhunë kibernetike ndaj grave", duke e përkufizuar atë si një formë të dhunës me bazë gjinore të kryer duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, e cila shkakton ose mund të shkaktojë dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik. Dhuna kibernetike konsiderohet pjesë e një vazhdimësie të dhunës ndaj grave, e jo një fenomen i izoluar, dhe është e lidhur me forma të ndryshme të dhunës së përditshme. Kjo Direktivë përcakton hapa praktikë se si të zbulohet dhe parandalohet dhuna ndaj grave në të gjithë Bashkimin Evropian, me qëllim që të sigurohet mbrojtje e qëndrueshme ndaj abuzimit fizik dhe digjital në të gjitha shtetet anëtare. Ajo thekson se "dispozitat e kësaj Direktive duhet të zbatohen për të gjitha viktimat e sjelljes kriminale që përbën dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, siç është e kriminalizuar nga ligji i Bashkimit Evropian ose ai kombëtar. Kjo përfshin veprat penale të përcaktuara në këtë Direktivë, përkatësisht shpërndarjen pa pëlqim të materialeve intime ose të manipuluar, përndjekjen kibernetike, ngacmimin kibernetik, ekspozimin e papritur të përmbajtjes seksuale (angl. Cyberflashing) dhe nxitjen kibernetike për dhunë ose urrejtje."

Disa direktiva dhe rregullore të BE-së, duke përfshirë edhe **Direktivën për të Drejtat e Viktimave (2019/29/BE)**, **Direktivën për Luftimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve (2011/93/BE)**, dhe **Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave**, janë të zbatueshme edhe në rastet e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia.

Në një shkallë më të gjerë, organizata të tilla si Këshilli i Evropës dhe Kombet e Bashkuara kanë ndërmarrë hapa për të adresuar DhGV LT-në. Disa traktate të Këshillit të Evropës mbulojnë aspekte të caktuara të dhunës kibernetike, ndërsa në vitin 2021, Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (**GREVIO**) i Këshillit të Evropës **publikoi Rekomandimin nr. 1**, për të theksuar dimensionin digjital në rritje të dhunës së drejtuar ndaj grave dhe vajzave. Megjithatë, mbledhja e të dhënave është e paqëndrueshme midis vendeve. Në rastet kur informacioni është i disponueshëm, shpesh mungon klasifikimi i duhur dhe detajet, dhe të dhënat mbulojnë vetëm lloje të caktuara të dhunës kibernetike, gjë që e vështirëson kuptimin dhe adresimin e plotë të problemit. Zhvillimi i një qasje të koordinuar për politikën dhe mbledhjen e të dhënave në nivel ndërkombëtar do të jetë thelbësor për të adresuar në mënyrë efektive DhGV LT-në.

GREVIO, organi ekspert i Këshillit të Evropës për dhunën ndaj grave, vuri në dukje se ligjet ekzistuese që adresojnë dhunën online ose dhunën atë të lehtësuar nga teknologjia shpesh përqendrohen kryesisht në mbrojtjen e sigurisë fizike, reputacionit ose pronës. Fatkeqësisht, këto

⁴ Luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Parlamenti Evropian, Përmbledhje 30-05-2024, Linku: [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI\(2023\)739392](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI(2023)739392)

ligje shpesh nuk i marrin parasysh efektet e tjera kritike të kësaj dhune, duke i përfshirë dëmet sociale, ekonomike, psikologjike dhe ato që lidhen me pjesëmarrjen, dhe rrallëherë e njohin natyrën komplekse dhe kumulative të dhunës që e përjetojnë gratë dhe vajzat në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe atë në internet. (GREVIO, 2021)⁵

Konventa e Stambollit (Këshilli i Evropës, 2011) shërben si kornizë ligjore bazë për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, duke i adresuar gjithnjë e më shumë format digjitale të dhunës me bazë gjinore. Ai e vendos maltretimin online brenda një vazhdimësie më të gjerë të dhunës që ndikon te gratë dhe vajzat në sfera të ndryshme të jetës.

Pastaj, **Konventa e Budapestit (Këshilli i Evropës, 2001)**, e cila është Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik, ofron masa për kriminalizimin e dhunës kibernetike, mbështet mbledhjen e provave dhe thekson nënvizon nevojën për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të abuzimit online. Kjo mbështetje është thelbësore për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të rasteve të dhunës kibernetike.⁶

Një përmirësim i rëndësishëm ishte **Protokolli i Dytë Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik** (Konventa e Budapestit) mbi forcimin e bashkëpunimit dhe zbulimin e provave elektronike (Protokolli), i cili synon të forcojë më tej bashkëpunimin në fushën e krimit kibernetik dhe aftësinë e autoriteteve të drejtësisë penale për të mbledhur prova elektronike për nevojat e hetimeve ose procedurave specifike penale. Protokolli u hap për nënshkrim nga Palët e Konventës së Budapestit në maj të vitit 2022.⁷

Përveç kësaj, **Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/Rec (2019)** (Këshilli i Evropës, 2019), megjithëse ende jo detyrues, luan një rol kyç si një “ligj i butë” duke i inkurajuar shtetet anëtare të parandalojnë dhe të luftojnë seksizmin, me theks të veçantë në gjuhën seksiste e urrejtjes në internet. Ky rekomandim, së bashku me **politikat e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) mbi gjuhën e urrejtjes**, e pasurojnë peizazhin ligjor dhe politik dhe ndihmojnë në promovimin e një qasje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës kibernetike.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
Në vitin 2017, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave miratoi Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 35, i cili e thekson ndërthurjen e faktorëve në dhunën ndaj grave dhe e zgjeron zbatueshmërinë e CEDAW-it në të gjitha mjediset ku teknologjia luan një rol ndërmjetësues. Një nga kontributet më të rëndësishme të këtij rekomandimi është njohja se dhuna ndodh në të gjitha sferat e ndërveprimit njerëzor, duke deklaruar në mënyrë eksplicite se “format bashkëkohore të dhunës kryhen në internet dhe në mjedise të tjera digjitale”.

Raportuesi Special i OKB-së për dhunën ndaj grave i shqyrtoi shkaqet dhe pasojat e dhunës digjitale ndaj grave dhe vajzave nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Raporti i thekson sfidat e reja që lidhen me dhunën në internet, duke u përqendruar te parandalimi, mbrojtja, ndjekja penale dhe mjetet juridike. Në vitin 2018, **Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut** ofroi një përkufizim të pranuar gjerësisht të dhunës me bazë gjinore online:

“Çdo akt dhune me bazë gjinore kundër grave që kryhet, lehtësohet ose përkeqësohet duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit — siç janë pajisjet mobile dhe

⁵ Rekomandimi i përgjithshëm nr. 1 i GREVIO-s mbi dimensionin digjital të dhunës ndaj grave, miratuar më 20 tetor 2021, linku: <https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147>;

⁶ “Luftimi i Dhunës Kibernetike ndaj Grave dhe Vajzave”, Instituti Evropian për Barazi Gjinore, 2022. Linku: https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/combating_cyber_violence_against_women_and_girls.pdf ;

⁷ Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale, korrik 2022, linku: <https://www.eurojust.europa.eu/publication/second-additional-protocol-budapest-convention-cybercrime-and-cross-border-access>

të zgjuara, interneti, platformat e rrjeteve sociale apo e-maili — duke i pasur për objektiv gratë për shkak të gjinisë së tyre ose që i prek ato në mënyrë disproporcionale.”

Edhe pse Raportuesi Special nuk ka për qëllim t’i dokumentojë të gjitha format e dhunës digjitale, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë digjitale, hapësirës online dhe inteligjencës artificiale po krijojnë vazhdimisht forma të reja të dhunës online. Raporti i jep përparësi çështjeve më urgjente dhe i thekson manifestimet bashkëkohore të dhunës digjitale ndaj grave dhe vajzave.

Rekomandimet e Raportuesit Special për vendet anëtare të OKB-së propozojnë një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia (DhBGj LT). Ato përfshijnë:

- Njohjen e **dhunës digjitale si shkelje të të drejtave të njeriut**,
- Forcimin **kornizave ligjore**,
- Promovimin e **arsimit dhe zhvillimit teknologjik**,
- Ofrimin e **përgjigjeve efektive ndaj dhunës online**.

Legjislacioni kombëtar

Kjo pjesë e analizës ofron një pasqyrë të detajuar të kornizës ligjore dhe politike kombëtare në lidhje me dhunën me bazë gjinore (DhBGj) dhe vlerëson se në çfarë mase ato janë të zbatueshme dhe i përfshijnë format digjitale të dhunës me bazë gjinore.

Maqedonia e Veriut ka krijuar një kornizë të fortë ligjore për të drejtat e grave, me politika që e promovojnë barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore. Dy ligje kyçe e pasqyrojnë përkushtimin për përmirësimin e të drejtave të grave. Maqedonia e Veriut, si nënshkruese e Konventës së Stambollit, është përafëruar me të duke e miratuar **Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2021)**. Ky ligj përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në mbrojtjen e grave në hapësirën digjitale. Ai e përkufizon në mënyrë eksplicite “ngacmimin seksual në internet si çdo sjellje verbale, joverbale ose sjellje tjetër me karakter seksual, që ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshin dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike me bazë gjinore në përkufizimin e saj, por nuk e trajton në mënyrë specifike dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia. Megjithatë, disa vepra penale të përfshira në Kodin Penal janë të zbatueshme për dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia, më të rëndësishmet prej të cilave janë si më poshtë:

1. **Neni 144** i referohet veprës penale të rrezikimit të sigurisë, duke theksuar në paragrafin 5 se kushdo që nëpërmjet një sistemi informacioni, kërcënohet se do të kryejë vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burgim prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë, kundër një personi për shkak të përkatësisë së tij në një grup të caktuar kombëtar, etnik ose racor ose përkatësisë fetare, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. **Neni 144-a** e kriminalizon përndjekjen⁸, Kushdo që ndjek, përndjek ose ndërhyr vazhdimisht pa autorizim në jetën personale të një personi tjetër apo krijon ose përpiket të vendosë

⁸ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, nr. 08-789/1 i datës 13.02.2023, Maqedonia e Veriut, <https://ldbis.pravda.gov.mk/PregledNaZakon.aspx?id=62139>

kontakt të padëshiruar me të duke lëvizur në hapësirën ku ndodhet ai person, duke abuzuar me përdorimin e të dhënave personale, duke përdorur mjetet e informimit publik ose mjete të tjera komunikimi, ose në çfarëdo mënyre tjetër e abuzon, ngacmon ose frikëson psikikisht atë dhe në këtë mënyrë shkakton një ndjenjë pasigurie, shqetësimi ose frike për sigurinë e tij ose sigurinë e një personi të afërt me të, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Neni 149 i referohet keqpërdorimit të të dhënave personale. Ky nen përcakton se kushdo që mbledh, përpunon ose përdor të dhëna personale në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me ligj, pa pëlqimin e qytetarit, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. I njëjti dënim penal zbatohet për këdo që ndërhyr në një sistem informacioni kompjuterik me të dhëna personale, me qëllim që t'i përdorë ato për vete ose për një tjetër, për të përfituar ndonjë dobi ose për t'i shkaktuar dëm një personi tjetër. Megjithatë, ky nen nuk ka perspektivë gjinore dhe i mungojnë dispozitat që e trajtojnë keqpërdorimin e të dhënave personale si një formë e dhunës digjitale me bazë gjinore.
3. Neni 152 trajton veprën penale që ka të bëjë me personin, i cili pa autorizim do të bëjë incizime fotografike, filmike ose me video të një personi tjetër ose të ambienteve të tij personale pa pëlqimin e tij, duke e shkelur privatësinë e tij ose personi që incizimet e tilla drejtpërdrejt ia përcjell një personi të tretë ose ia tregon atij ose në ndonjë mënyrë tjetër i mundëson të njoftohet me përmbajtjen e tyre, do të dënohet me dënim me para ose me burgim deri në një vit. Këtij neni gjithashtu i mungon një vepër e kualifikuar dhe një dënim më i ashpër nëse kjo vepër penale kryhet si formë e dhunës digjitale me bazë gjinore në formën e ekspozimit të papritur të përmbajtjes seksuale (angl. Cyberflashing), pornografisë pa pëlqim dhe/ose pornografisë hakmarrëse.
4. Neni 190-a e kriminalizon ngacmimin seksual, duke përfshirë edhe ngacmimin online. Ky nen përcakton se kushdo që, me veprim verbal, joverbal ose fizik, si dhe duke i përdorur mjetet e komunikimit elektronik, që kanë kuptim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, real ose simbolik të nxitjes, ofertës së pahijshme, joshjes, shprehjes së pasionit seksual ose një veprimi tjetër që i ngjan qartë marrëdhënies seksuale ose akteve të tjera seksuale të barasvlershme me të, dhe në këtë mënyrë cenon dinjitetin e tjetrit, duke shkaktuar një ndjenjë shqetësimi, ofendimi, poshtërimi ose frike, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
5. Neni 193 e kriminalizon shfaqjen e materialit pornografik para të miturve: Kushdo që shet, shfaq ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion një të mituri nën moshën 14 vjeç fotografi, objekte audiovizuale dhe objekte të tjera me përmbajtje pornografike ose i shfaq atij një shfaqje pornografike, si dhe kushdo që merr pjesë në shfaqje, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. E dënohet me një dënim me burgim nga tre deri në pesë vjet nëse vepra penale kryhet përmes mjeteve të informimit publik.
6. Neni 193-a ndalon prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë: Kushdo që prodhon pornografi me fëmijë me qëllim të shpërndarjes së saj ose e transmeton, ofron ose në ndonjë mënyrë tjetër e bën të disponueshme pornografinë me fëmijë, do të dënohet me burgim prej të paktën pesë vjetësh. E me dënim me burg prej të paktën tetë vjetësh nëse kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik ose mjeteve të tjera të komunikimit masiv.

Megjithatë, në kuadër të veprave të tjera penale të mbuluara nga Kodi Penal, nevojitet një rregullim më i detajuar lidhur me shkeljen e të drejtave në hapësirën digjitale, veçanërisht në

lidhje me veprat e mëposhtme penale: keqpërdorimi i të dhënave personale, incizimi i paautorizuar, ndërmjetësimi në prostitucion, shfaqja e përmbajtjes seksuale para një tjetri dhe forma të tjera të diskriminimit ose abuzimit online.

Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje përkufizon forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, duke edhe ngacmimin seksual përmes internetit. Kjo përkufizohet si çdo sjellje verbale, joverbale ose sjellje tjetër me karakter seksual, që ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit. Megjithatë, ligji i mungon një përkufizim i detajuar i dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia (DhBGj) dhe formave të saj specifike. Ligji përcakton masa mbrojtëse kundër dhunës me bazë gjinore, të cilat mund të kategorizohen në tre grupe kryesore: masa për të parandaluar riviktimizimin, masa emergjente dhe të përkohshme mbrojtëse dhe mbrojtje gjyqësore. Edhe pse ligji mbështet një qasje shumësektoriale për zbatimin e këtyre masave mbrojtëse, duke përmendur aktivitete konkrete dhe aktorë përkatës për zbatimin e tyre, duket se këto masa fokusohen kryesisht në dhunën fizike dhe psikologjike, pa ofruar mbrojtje të qartë kundër dhunës digjitale me bazë gjinore. Ekziston një boshllëk në ligj në lidhje me masat specifike për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia. Për më tepër, ligji ofron shërbime të përgjithshme dhe specifike për viktimat e dhunës me bazë gjinore.⁹ Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme, ligji i thekson shërbimet shëndetësore dhe sociale për të gjitha viktimat e dhunës me bazë gjinore. Shërbimet specifike për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë të përshtatura sipas nevojave të atyre që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore.¹⁰ Ligji¹¹ nuk ka masa specifike për viktimat e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia.

Ligji për Procedurën Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut e rregullon kornizën procedurale për procedurat penale. Ai i përcakton hapat për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale. Megjithatë, mund të nevojiten ndryshime për të ofruar udhëzime më të qarta se si duhet trajtuar rastet e dhunës së lehtësuar nga teknologjia.¹²

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹³ i Republikës së Maqedonisë së Veriut e rregullon përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë **Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)** të Bashkimit Evropian. Ligji është hartuar për të siguruar privatësinë dhe sigurinë e të dhënave personale të individëve duke vendosur rregulla mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave. Edhe pse ligji përqendrohet kryesisht në mbrojtjen e të dhënave personale, ai është veçanërisht i rëndësishëm për rastet e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia (DhBGj), pasi ndihmon në mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm të viktimave nga qasja e paautorizuar, keqpërdorimi ose zbulimi. Për shembull, ky ligj mund të zbatohet në situata që përfshijnë shpërndarjen e paautorizuar të fotografive intime ose të dhënave personale pa

⁹ Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, neni 88

¹⁰ Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, neni 89

¹¹ LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE, nr. 08-524/1, 27 Janar 2021, Maqedonia e Veriut, Shkup. Linku:

<https://mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/1a28a922f364401e94935d4d694b9d75.pdf>

¹² Analizë e legjislacionit në lidhje me dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia, UNDP, dhjetor 2024, linku: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-12/final-analysis-tf-gbv.pdf>

¹³ LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, nr. 08-1417/1, 16 shkurt 2020, Maqedonia e Veriut, Shkup. Linku: https://azlp.mk/wp-content/uploads/2022/11/zakon_za_zastita_na_licnite_podatoci.pdf

pëlqimin e viktimave, duke siguruar kështu respektimin e të drejtave të privatësisë së viktimave. Ligji kërkon që të dhënat personale të përpunohen në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të sigurt, gjë që është thelbësore për adresimin e keqpërdorimit të informacionit personal në kontekstin e ngacmimit online, përndjekjes ose formave të tjera të dhunës së lehtësuar nga teknologjia. Megjithatë, aktet nënligjore që çdo “kontrollues” duhet t’i miratojë në lidhje me kornizat për mbrojtjen e të dhënave mund të përmirësohen me dispozita më të qarta që e trajtojnë ndërthurjen midis mbrojtjes së të dhënave dhe dhunës digjitale me bazë gjinore, për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat në hapësirën digjitale.

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut synon të parandalojë diskriminimin në të gjitha format e tij dhe të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët. Ligji përqendrohet në mbrojtjen nga diskriminimi mbi baza të gjinisë, racës, kombësisë, përkatësisë etnike, fesë, orientimit seksual, aftësive të kufizuara dhe baza të tjera, si dhe përfshin mekanizma për parashtrimin e ankesave dhe kërkimin e mbrojtjes ligjore. Në kontekstin e **dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia (DhBGj)**, ky ligj mund të jetë thelbësor, pasi diskriminimi dhe dhuna ndaj grave në hapësirën digjitale shpesh janë të ndërlidhura. Diskriminimi ndaj grave në internet, përndjekja, ngacmimi, shpërndarja pa pëlqim e fotografive intime dhe gjuha e urrejtjes me bazë gjinore mund të identifikohen si forma të diskriminimit që duhet të adresohen në kuadër të këtij ligji. Për të garantuar mbrojtje të plotë të viktimave të DhBGj-së, është e nevojshme të përfshihen dispozita specifike që lidhen me teknologjitë dhe hapësirën digjitale si bazë për diskriminim. Këto dispozita mund të ofrojnë masa shtesë për mbrojtjen e viktimave të DhBGj-së së lehtësuar nga teknologjia dhe t’i inkurajojnë institucionet që t’i mbrojnë viktimat në sferën digjitale ashtu siç bëjnë në hapësirat fizike.

Ligji për Ndihmën Juridike Falas i Republikës së Maqedonisë së Veriut u garanton qytetarëve të drejtën për të marrë ndihmë juridike falas në kushte të caktuara, me qëllim që të sigurohet qasje në drejtësi për personat që nuk kanë mundësi financiare për t’i paguar shërbimet juridike. Ky ligj zbatohet në fusha të ndryshme të së drejtës, duke përfshirë çështjet civile, penale dhe administrative. Që ky Ligj të jetë plotësisht efektiv në adresimin e DhBGj-së së lehtësuar nga teknologjia, ai duhet të përmbajë dispozita të qarta për viktimat e dhunës digjitale dhe të inkurajojë ofrimin e shërbimeve të specializuara juridike për format e abuzimit, ngacmimit dhe shkeljes së privatësisë online. Kjo do t’u mundësonte viktimave të ndërmarrin veprime ligjore kundër autorëve që përdorin platformat digjitale për qëllime të dëmshme.

Protokolli për Bashkëpunimin e Ndërsjellë të Subjekteve Kompetente për Ndërmarrjen e Masave për Parandalimin, Pengimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një dokument strategjik që i përcakton përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e institucioneve dhe organizatave të ndryshme të përfshira në trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Protokolli parashikon një qasje të koordinuar dhe shumësektoriale midis organeve të zbatimit të ligjit, institucioneve shëndetësore, shërbimeve sociale, gjyqësorit, organizatave joqeveritare dhe palëve të tjera të interesuara për të ofruar mbrojtje dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat. Në lidhje me **dhunën me bazë gjinore (DhBGj) të lehtësuar nga teknologjia**, Protokolli¹⁴ luan një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve përkatës për rreziqet që lindin në hapësirën digjitale. Edhe pse dokumenti përqendrohet kryesisht në dhunën fizike dhe psikologjike, ai ofron një bazë të

¹⁴ Protokolli për Bashkëpunimin e Ndërsjellë të Subjekteve Kompetente për Ndërmarrjen e Masave për Parandalimin, Pengimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2023, në dispozicion në: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/Protocol_MKD.pdf

rëndësishme për përfshirjen e masave specifike për të mbrojtur viktimat nga ngacmimi online, përndjekja kibernetike, pornografia hakmarrëse dhe forma të tjera të abuzimit kibernetik. Duke përfshirë dispozita për trajtimin e dhunës digjitale dhe duke trajnuar palët e interesuara për ta njohur dhe adresuar këtë formë të re të dhunës, Protokoli mund të përmirësojë ndjeshëm reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore (DhBGj) të lehtësuar nga teknologjia, duke siguruar që viktimat të marrin mbrojtje dhe qasje në drejtësi edhe në sferën digjitale.

Strategjia për Barazi Gjinore 2022-2027 (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022) në Maqedoninë e Veriut¹⁵ është një kornizë kyçe e politikave që synon avancimin e të drejtave dhe mundësive të grave. E prezantuar në korrik të vitit 2022, ajo përcakton qëllime të qarta për të zvogëluar pabarazitë gjinore, për të rritur përfaqësimin e grave dhe për të adresuar dhunën me bazë gjinore në sektorë të ndryshëm. Nga ana tjetër, mungesa e rregulloreve specifike për dhunën digjitale ndaj grave kontribuon në sulmet kibernetike, veçanërisht ndaj grave në pozicione publike sipas Indeksit të Barazisë Gjinore¹⁶. Këto sulme shpesh i kanë në shënjestër gratë profesioniste, me qëllim të heshtjes së tyre dhe përjashtimit nga diskursi publik. Të motivuar nga arsye politike, sociale ose ideologjike, këta ngacmues kibernetikë përdorin frikësimin si mjet për të imponuar bindjet e tyre dhe për të dekurajuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

Rastet dhe ndikimi në legjislacion

Studimi i OSBE-së nga viti 2022¹⁷, me titull “*Nga normalizimi në vetëcensurë – Analizë e ngacmimit online në Maqedoninë e Veriut*”, i përshkruan në detaje llojet e ngacmimit online të përjetuara nga gazetaret femra. Hulumtimi tregon se sulmet ndodhin kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale dhe shpesh përmbajnë elementë seksiste dhe mizogjene, gjë që e përkeqëson ngacmimin me të cilin përballen këto gra që thjesht janë duke i kryer detyrat e tyre profesionale. Ky diskriminim nxjerr në pah një armiqësi të rrënjosur thellë që synon posaçërisht heshtjen e zërave të grave në media dhe hapësirat publike.

Këto raste të dhunës online ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut e nxjerrin në pah problemin e përhapur të dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave (DhGV LT) në vend. Studimi nënvizon se një dhunë e tillë është një formë e ngacmimit me bazë gjinore dhe se kërkon një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë nga institucionet përgjegjëse për trajtimin e këtyre sulmeve.

Qëllimi i këtyre sulmeve online nuk është vetëm të heshtin gazetarët individualë, por edhe të ndikojnë në audiencën e tyre, dhe, në këtë mënyrë, të ndikojnë në mënyrë indirekte edhe mbi gratë e tjera që ndajnë pikëpamje të ngjashme ose që punojnë në sferën publike. Ky efekt i ndikimit nënkupton që ndikimi i ngacmimeve shtrihet përtej vetë gazetarëve, duke krijuar një atmosferë frikësimi për gratë në përgjithësi.

Në janar të vitit 2020, u zbulua një grup në Telegram i quajtur "Dhoma Publike", në të cilin ndaheshin foto intime private, profile në rrjetet sociale dhe numra telefoni privatë të grave dhe vajzave midis më shumë se 7,000 anëtarëve meshkuj të grupit. Me kërkesë të Ministrisë së Punëve

¹⁵ Strategjia për Barazi Gjinore, MPPS, 2022, Linku;

https://natlex.ilo.org/dyn/natlex2/r/natlex/fe/details?p3_isn=116973

¹⁶ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Indeksi i Barazisë Gjinore, 2022, Maqedonia e Veriut, Linku:

https://cms.mtsp.gov.mk/content/pdf/2023/Gender-Index-2022_EN-web.pdf

¹⁷ ANALIZË E OSBE-së mbi ngacmimin online të gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, 2022. Linku: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/526988_0.pdf

të Brendshme, grupi në Telegram u mbyll, por asnjë nga anëtarët nuk u akuzua. Pas një vale reagimesh publike, pasoi një përgjigje konstruktive nga autoritetet legislative.

Në vitin 2023, Maqedonia bëri një ndryshim të rëndësishëm në Kodin Penal duke e futur “përndjekjen” si vepër penale — që ishte një hap kyç drejt forcimit të mbrojtjes nga dhuna kibernetike që i ka në shënjestër gratë dhe vajzat (DhBGj LT). Ky nen i ri (neni 144-a) i Kodit Penal, i cili e trajton konkretisht përndjekjen në kontekstin e dhunës në internet, në masë të madhe ishte rezultat i presionit publik dhe protestave pas disa rasteve shqetësuese të dhunës me bazë gjinore, si në internet ashtu edhe jashtë tij. Në të thuhet se “Kushdo që ndjek, përndjek ose ndërhyr vazhdimisht pa autorizim në jetën personale të një personi tjetër apo krijon ose përpiket të vendosë kontakt të padëshiruar me të duke lëvizur në hapësirën ku ndodhet ai person, duke abuzuar me përdorimin e të dhënave personale, duke përdorur mjetet e informimit publik ose mjete të tjera komunikimi, ose në çfarëdo mënyre tjetër e abuzon, ngacmon ose frikëson psikikisht atë dhe në këtë mënyrë shkakton një ndjenjë pasigurie, shqetësimi ose frike për sigurinë e tij ose sigurinë e një personi të afërt me të, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2023)

Ndryshimet e fundit në Kodin Penal pritet të luajnë një rol kyç në përmirësimin e rezultateve ligjore në rastet që përfshijnë dhunën online ndaj grave. Më parë, shumë kallëzime arrinin në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose në Prokurorinë Themelore Publike, por vetëm disa prej tyre përfundonin në gjykatë, me ç’rast shumica e rasteve ose hidheshin poshtë ose mbeteshin të pazgjidhura¹⁸. Dispozitat e reja ofrojnë një kornizë të qartë për gjetjen e një mënyre ligjore për të ndjekur penalisht rastet e dhunës kibernetike, duke ofruar mbrojtje më të fortë ligjore për gratë që janë në shënjestër të ngacmimit online dhe formave të tjera të abuzimit digjital. Sipas autoriteteve të vendit, ndryshimet e reja e bëjnë më të qartë mbrojtjen ekzistuese për gratë duke futur vepra të reja penale që lidhen drejtpërdrejt me dhunën kibernetike. Ky ndryshim nënkupton që gratë tani kanë mbrojtje ligjore nga format e ndryshme të ngacmimit online dhe kërcënimeve digjitale, gjë që paraqet një përparim të rëndësishëm në reagimin institucional ndaj kërcënimeve kibernetike dhe dhunës kibernetike.

Aktualisht, Sektori i Krimit Kompjuterik dhe Mjekësisë Ligjore në kuadër të SSP – Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbetet institucioni kryesor përgjegjës për trajtimin e incidenteve të dhunës online dhe për mbledhjen e provave digjitale. Megjithatë, prokuroria ende ka përgjegjësinë për të vendosur nëse një rast i caktuar ka baza të mjaftueshme për të vazhduar me ndjekje penale. Shpesh lindin sfida gjatë mbledhjes së provave, veçanërisht kur autorët përdorin profile anonime, rrjete private (VPN) ose mjete të tjera për mbrojtjen e privatësisë, të cilat shpesh kërkojnë bashkëpunim juridik ndërkombëtar për identifikimin dhe verifikimin e tyre. Këto kompleksitete jo vetëm që e bëjnë të vështirë mbledhjen e provave, por edhe zgjasin kohëzgjatjen për zgjidhjen e rasteve, duke rezultuar shpesh në hedhje poshtë të rasteve ose hetime të papërfunduara.

¹⁸ Suzana Miceva, Veronika D., Artikull mediatik: “Sistemi nuk i njeh viktimat e përndjekjes dhe të dhunës në familje”, publikuar më 15.04.2024, në dispozicion në: <https://lokalaktiv.mk/2024/10/15>

Baza e të dhënave të aktorëve kryesorë

Ky është një dizajn i strukturuar i bazës së të dhënave për aktorët kryesorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë të përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kibernetike me bazë gjinore. Baza e të dhënave përfshin **llojin e organizatës dhe fushat kryesore të ndërhyrjes**.


Numri i identifikimit	Emri i institucionit	Lloji	Përgjegjësitë kryesore
1	Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	Qeveritare	Hetimi i krimit kibernetik, zbatimi i ligjit
2	Spektori i Krimit Kompjuterik dhe Mjekësisë Ligjore (MPB)	Qeveritare	Mjekësia ligjore digjitale, trajtimi i rasteve të krimit kibernetik
3	Njësitë rajonale të MPB-së – Sektorët e Punëve të Brendshme SPB Shkup – Njësia e Krimit Ekonomik dhe Kompjuterik	Qeveritare	Hetimi i krimit ekonomik dhe kompjuterik dhe ngritja e padive penale në Prokurorinë Publike
5	Qendrat e hetimit në kuadër të prokurorive publike në Maqedoninë e Veriut	Qeveritare	Mbështetje për hetimet dhe ndjekjet penale
7	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve	Qeveritare	Mbështetje sociale për viktimat
8	Qendrat për Punë Sociale	Qeveritare	Mbështetje psiko-sociale për viktimat
9	Gjykatat Themelore dhe Gjykata e Apelit në Shkup	Qeveritare	Procedimi i rasteve në gjykatat themelore dhe trajtimi i ankesave në rastet e dhunës kibernetike
10	Ministria e Drejtësisë	Qeveritare	Reformat e politikave dhe ato legjislativë
11	Agjencia e Komunikimeve Elektronike	Qeveritare	Rregullimi i komunikimit online dhe të drejtave digjitale
12	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	Qeveritare	Trajtimi i ankesave për diskriminim
13	Avokati i Popullit	Qeveritare	Mbrojtja e të drejtave të njeriut
14	Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore	Qeveritare	Hartimi i politikave për barazi gjinore
15	Organizatat joqeveritare (OJQ)	Joqeveritare	Ngritje e vetëdijes, mbështetje për viktimat, ndihma juridike
16	Komuniteti akademik (universitetet, qendrat hulumtuese)	Joqeveritare	Hulumtime dhe rekomandime për politika
17	Mediat	Joqeveritare	Edukimi i publikut dhe avokimi

Gjetjet e anketës

Anketë për aktivistët e shoqërisë civile mbi dhunën kibernetike me bazë gjinore ndaj grave të reja

1. За каков тип организација работите?

19 responses



Pyetja 1: Për çfarë lloj organizate punoni?

Kësaj pyetjeje iu përgjigjën gjithsej 19 përfaqësues. Prej tyre:

- 84,2% janë nga sektori joqeveritar dhe aktivistë të shoqërisë civile
- 5,3% janë nga organizatat për të drejtat e grave
- 5,3% janë nga sektori shëndetësor
- Të tjerët janë nga organizata të llojeve të tjera.

Interpretimi i të dhënave:

Shumica e të anketuarve (mbi 4 nga 5) punojnë në sektorin joqeveritar dhe të shoqërisë civile, gjë që tregon se mostra përbëhet kryesisht nga individë të përfshirë në aktivitete të avokimit, punë në komunitet ose aktivizëm. Ky përfaqësim i fortë mund ta pasqyrojë rëndësinë ose interesin për temën e anketës brenda organizatave joqeveritare.

Vetëm një përqindje e vogël (5,3% e tyre) janë të lidhur me organizatat për të drejtat e grave dhe sektorin e shëndetësisë, gjë që tregon se anketa ose kishte mbulim të kufizuar ose kishte një formulim më të gjerë që nuk ishte i synuar posaçërisht për këta sektorë. Kategoria “tjetër” mbetet e paqartë, por përqindja e saj e vogël tregon një larmi të kufizuar jashtë grupeve kryesore të përmendura.

Kjo shpërndarje mund të ndikojë në mënyrën se si interpretohen rezultatet e anketës, pasi pikëpamjet e përbashkëta janë kryesisht të formuara nga përvoja e shoqërisë civile dhe sektorit joqeveritar.

2. Kolku долго сте вклучени во активизам против родово базирано сајбер насилство?

19 responses



Pyetja 2: Sa kohë keni qenë të përfshirë në aktivizëm kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore?

Shumica e të anketuarve, 36,8%, kanë midis 1 dhe 3 vjet përvojë në aktivizëm kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore.

Për më tepër:

- 26,3% kanë 4 deri në 7 vjet përvojë
- 15,8% kanë mbi 8 vjet përvojë në këtë fushë
- 10,5% kanë më pak se një vit përvojë

Interpretimi i të dhënave:


Shumica e pjesëmarrësve janë relativisht të rinj në këtë fushë, me ç'rast mbi një e treta (36,8%) kanë 1 deri në 3 vjet përvojë, gjë që tregon për një angazhim në rritje në vitet e fundit. Grupi i dytë më i madh (26,3%) përbëhet nga ata që kanë përvojë mesatare (4–7 vjet), gjë që tregon se ka një bërthamë të fortë aktivistësh me përfshirje të vazhdueshme.

Pastaj, 15,8% kanë mbi 8 vjet përvojë, që përfaqëson një grup më të vogël avokuesish me përvojë të gjatë, të cilët me siguri kanë njohuri të vlefshme institucionale dhe kontekst historik për këtë çështje. Ndërkohë, 10,5% janë të fillestarë, që janë të përfshirë për më pak se një vit, gjë që mund të tregojë për rritje të ndërgjegjësimit dhe interes në rritje për të adresuar dhunën kibernetike me bazë gjinore.

Në përgjithësi, të dhënat ilustrojnë një peizazh aktivistësh dinamik dhe në zhvillim e sipër, me një përzierje të dobishme të avokuesve me përvojë dhe zërave të rinj, që tregon si qëndrueshmëri ashtu edhe impuls të ri në luftën kundër dhunës me bazë gjinore online.

3. Koja e вашата примарна uloga na organizacijata? Можни се повеќе одговори

19 responses



Pyetja 3: Cili është roli juaj kryesor në organizatë? Mund të ketë disa përgjigje.

Shumica e të anketuarve, ose 68,4%, punojnë në organizata që fokusohen në fushata për ngritjen e vetëdijes publike, avokim për ndryshime dhe zhvillim politikash.

Vetëm 21,1% janë të përfshirë në ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat, ndërsa 10,5% ofrojnë mbështetje juridike.

Shumë pak organizata kanë një rol parësor në ndërtimin e rezistencës tek të rinjve ose në punën e drejtpërdrejtë me të rinjtë.

Interpretimi i të dhënave:


Gjetjet tregojnë se fokusi dominues (68,4%) i organizatave pjesëmarrëse është i drejtuar drejt avokimit, ngritjes së vetëdijes dhe zhvillimit të politikave, gjë që tregon se ka një qasje strategjike dhe sistematike në adresimin e dhunës kibernetike me bazë gjinore. Këto përpjekje synojnë të bëjnë ndryshime shoqërore afatgjata duke ndikuar në opinionin publik dhe në kornizat ligjore.

Kundrejt kësaj, vetëm rreth një e pesta (21,1%) e organizatave ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për viktimat, kurse një pjesë edhe më e vogël (10,5%) përqendrohen në ndihmën juridike. Kjo tregon një mungesë të mundshme të shërbimeve kur bëhet fjalë për ndihmën emergjente në terren për njerëzit e prekur nga dhuna kibernetike.

Për më tepër, iniciativat që fokusohen te të rinjtë janë dukshëm më pak të përfaqësuara, edhe pse të rinjtë janë shpesh ndër më të cenueshmit ndaj abuzimeve online. Përfshirja e kufizuar në ndërtimin e qëndrueshmërisë midis të rinjve sugjeron se nevojiten investime dhe zhvillime programesh në të ardhmen në këtë fushë për të siguruar qasje më gjithëpërfshirëse dhe parandaluese. Në përgjithësi, ndërsa avokimi dhe angazhimi për sa i përket politikave janë të forta, ekosistemi mund të përfitojë nga mekanizma më të fortë të mbështetjes së viktimave dhe ndërhyrjet e fokusuara te të rinjtë.

4. Кои форми на сајбер насилство најчесто ги доживуваат жртвите со кои работите? Можни се повеќе одговори

19 responses



Pyetja 4: Cilat forma të dhunës kibernetike i përjetojnë më shpesh viktimat me të cilat punoni? Mund të ketë disa përgjigje.

Format më të zakonshme të dhunës kibernetike që i përjetojnë viktimat janë:

- Gjuha e urrejtjes – 84,2%
- Ngacmimi online - 63,2%
- Shpërndarja e fotografive pa pëlqim – 63.2%
- Përndjekja kibernetike – 47,7%
- Zbulimi publik i informatave private/përmbajtjeve të pahijshme – 47,7%. Përveç kësaj, 15,8% e përgjigjeve hyjnë në kategorinë "të tjera", ku bëjnë pjesë forma të dhunës që nuk janë përmendur konkretisht ose që nuk janë zbuluar.

Interpretimi i të dhënave:

Të dhënat tregojnë një përhapje shqetësuese të **gjuhës së urrejtjes (84,2%)**, duke e bërë atë formën më të zakonshme të dhunës kibernetike të raportuar nga viktimat. Kjo sugjeron se gjuha diskriminuese ose armiqësore në internet mbetet një kërcënim i madh, që me gjasë pasqyron probleme më të gjera shoqërore, siç janë seksizmi, homofobia ose racizmi.


Ngacmimi online dhe shpërndarja e fotografive pa pëlqim u raportuan nga 63,2% e të anketuarve, gjë që e nxjerr në pah dëmin psikologjik dhe të reputacionit që viktimat shpesh e përjetojnë në hapësirat digjitale. Këto forma të abuzimit shpesh ndërthuren mes tyre, duke e përforcuar ndikimin negativ.

Pothuajse gjysma (47,7%) e viktimave përjetojnë **përndjekje kibernetike dhe zbulimi publik i përmbajtjeve private ose të pahijshme, që tregojnë shkelje serioze të privatësisë dhe sigurisë personale**. Përqindja prej 15,8% e shënuar si "tjetër" tregon një larmi kërcënimesh kibernetike të reja ose më pak të njohura që mund të mos përfshihen në kategorizimet standarde, duke e theksuar nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe kuptim më të thellë të fenomenit.

Në përgjithësi, të dhënat e nxjerrin në pah natyrën shumështrësore dhe të vazhdueshme të dhunës kibernetike, duke e theksuar nevojën urgjente për mekanizma gjithëpërfshirës mbrojtës, reforma ligjore dhe shërbime mbështetëse të përqendruara te viktimat.

5. Колку често жртвите бараат помош од вашата организација?

19 responses



Pyetja 5: Sa shpesh viktimat kërkojnë ndihmë nga organizata juaj?

- 68,4% e të anketuarve deklaruan se viktimat rrallëherë kërkojnë ndihmë.
- 21,1% deklaruan se viktimat i kontaktojnë një herë në muaj
- 10,5% thanë se viktimat kërkojnë ndihmë çdo ditë

Interpretimi i të dhënave:

Shumica e të anketuarve - 68,4% deklaruan se **viktimat rrallë kërkojnë ndihmë** - gjë që tregon se ka një hendek të konsiderueshëm midis ekzistencës së shërbimeve mbështetëse dhe përdorimit të tyre real nga viktimat. Kjo mund të jetë pasojë e informimit të pamjaftueshëm, **frikës nga stigmatizimi**, mosbesimit ndaj institucioneve ose disponueshmërisë së kufizuar të shërbimeve.


Vetëm 21,1% e organizatave marrin kërkesa mujore për ndihmë, gjë që tregon për një nivel modest të angazhimit, ndërsa vetëm 10,5% kanë kontakt të përditshëm me viktimat, gjë që ndoshta nënkupton shërbime shumë të specializuara ose të konsoliduara mirë.

Këto gjetje e theksojnë nevojën urgjente **për forcimin e aktiviteteve informuese**, ndërtimin e besimit dhe sigurimin që viktimat të jenë të informuara për **sistemet e mbështetjes që janë në dispozicion** dhe të ndihen të sigurta kur i përdorin ato. Po ashtu, kjo mund të tregojë rëndësinë e fushatave të edukimit publik dhe të mekanizmave të thjeshtuar për raportim, për t'i inkurajuar viktimat që të kërkojnë ndihmë.

6. Кои се главните пречки во обезбедувањето поддршка за жртвите? Можни се повеќе

одговори

19 responses



Pyetja 6: Cilat janë pengesat kryesore në ofrimin e mbështetjes për viktimat? Mund të ketë disa përgjigje.

- 78,9% e të anketuarve thanë se pengesa kryesore është mungesa e ndërgjegjësimit.
- 63,2% përmendën mungesën e financave
- 47,7% përmendën rezistencën e institucioneve
- 36,8% i theksuan pengesat ligjore
- 10,5% identifikuan pengesa të llojeve të tjera

Interpretimi i të dhënave:

Pengesa më urgjente e raportuar nga organizatat është **mungesa e ndërgjegjësimit** (78,9%), gjë që thekson nevojën kritike për **përpjekje edukative** që synojnë si viktimat ashtu edhe publikun e gjerë. Pa një kuptim të qartë se çfarë përbën dhunë kibernetike ose ku mund të kërkojnë ndihmë, shumë viktima mund të mbeten pa mbështetje.

Kufizimet financiare (63,2%) gjithashtu paraqesin një kufizim të rëndësishëm, gjë që tregon se edhe organizatat e motivuara mund të përballen me vështirësi në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme ose cilësore pa mbështetje të mjaftueshme financiare.


Pothuajse gjysma (47,7%) e të anketuarve përmendën rezistencën institucionale, gjë që tregon për sfida sistemike - të tilla si mungesa e bashkëpunimit, reagimet e ngadalta ose pengesat burokratike - që e pengojnë mbështetjen efektive për viktimat. Gjithashtu u përmendën edhe **pengesat ligjore (36.8%)**, gjë që tregon se ka sfida që lidhen me legjislacionin e pamjaftueshëm, mungesën e zbatimit ose mjetet e kufizuara juridike për rastet e dhunës kibernetike.

Në fund, 10,5% e të anketuarve përmendën pengesa “të tjera”, gjë që nënkupton se ka sfida shtesë, ndoshta të varura nga konteksti, të cilat nuk janë përfshirë plotësisht me opsionet e ofruara.

Si përmbledhje, këto gjetje nxjerrin në pah një ekosistem kompleks barrierash, me ç’rast ndërgjegjësimi, financimi, bashkëpunimi institucional dhe korniza ligjore kërkojnë përmirësim të koordinuar për të ofruar mbështetje kuptimplote dhe të qasshme për viktimat e dhunës kibernetike.

7. Според вашето искуство, колку се ефикасни постоечките закони во справувањето со родово базираното сајбер насилство?

19 responses



Pyetja 7: Sipas përvojës suaj, sa efikase janë ligjet ekzistuese në trajtimin e dhunës kibernetike me bazë gjinore?

- 47,4% e të anketuarve thanë se ligjet nuk janë efikase.
- 31,6% thanë se ishin pjesërisht efikase
- 21,1% thanë se nuk ishin të sigurt për efikasitetin e ligjeve

Interpretimi i të dhënave:

Pothuajse gjysma e të anketuarve (**47,4%**) konsiderojnë se **ligjet ekzistuese nuk janë efikase** në trajtimin e dhunës kibernetike me bazë gjinore, gjë që tregon se ka pakënaqësi të përhapur gjerësisht me kornizën aktuale ligjore. Kjo tregon se ka mungesë të mjeteve të përshtatshme ligjore, zbatim të dobët ose mangësi në praktikën e zbatimit të ligjit.


31,6% e të anketuarve konsiderojnë se ligjet janë pjesërisht efikase, gjë që nënkupton se megjithëse është bërë njëfarë përparimi, nevojiten përmirësime të konsiderueshme në fusha të tilla si zbatimi i ligjit, mbrojtja e viktimave dhe përshtatja e ligjeve me format e reja të abuzimit online.

Pjesa e mbetur prej **21,1% nuk janë të sigurt**, gjë që mund të tregojë se ka njohuri të kufizuara për ligjet, zbatim jokonsekuent të ligjeve ose mungesë të qartësisë se si zhvillohen proceset ligjore në praktikë.

Në përgjithësi, të dhënat e theksojnë **nevojën kritike për reforma ligjore, mekanizma të përmirësuar për zbatimin e ligjit** dhe trajnim më të mirë për profesionistët, si dhe koordinim më të fortë institucional, për të siguruar që ligjet të shërbejnë si një mjete parandalues dhe burim mbrojtjeje për viktimat e dhunës kibernetike.

8. Какво е вашето искуство во соработката со државните институции за превенција и пријавување на онлајн насилство?

19 responses



Pyetja 8: Cila është përvoja juaj në bashkëpunimin me institucionet shtetërore për parandalimin dhe raportimin e dhunës online?

- **36,8%** deklaruan se nuk kanë pasur **përvojë të drejtpërdrejtë** me institucionet
- **31,6%** deklaruan se kanë pasur **përvojë deri diku pozitive**
- **15,8%** kanë pasur **përvojë negative** në bashkëpunim me institucionet shtetërore
- **10,5%** deklaruan se kanë pasur **përvojë shumë të keqe**
- Vetëm **5,3%** e përshkruan përvojën e tyre si **pozitive**

Interpretimi i të dhënave:

Rezultatet tregojnë se ka një **bashkëpunim të kufizuar dhe të larmishëm** midis aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në lidhje me parandalimin dhe raportimin e dhunës online.


Pjesa më e madhe -**36,8% — nuk kanë pasur përvojë të drejtpërdrejtë**, gjë që tregon për një mospërfshirje të mundshme ose mungesë të mekanizmave institucionalë për angazhim dhe bashkëpunim. Nga ana tjetër, **31,6%** deklaruan se kanë pasur **përvoja deri diku pozitive**, gjë që sugjeron se ka disa shembuj të bashkëveprimit konstruktiv, megjithëse nuk është i qëndrueshëm ose i përhapur gjerësisht.

Pastaj, **gjithsej 26,3%** (15,8% negative +10,5% shumë keq) **shprehën pakënaqësi**, që i nxjerr në pah frustrimet që mund të lindin nga pengesat burokratike, mungesa e përgjegjësisë ose kapaciteti i pamjaftueshëm institucional.

Është alarmante që **vetëm 5,3%** ata kanë pasur **përvojë vërtet pozitive**, gjë që tregon se ka **nevojë për të përmirësuar besimin ndaj institucioneve, trajnimin dhe komunikimin**.

Shkurtimisht, të dhënat tregojnë se për shumicën e të anketuarve bashkëpunimi me institucionet shtetërore ose është **i pamjaftueshëm, jokonsekuent ose problematik**, gjë që e thekson nevojën për **ndërtim sistematik të kapaciteteve, krijim të kornizave për partneritete dhe të protokolleve transparente** për të mbështetur më mirë parandalimin dhe raportimin e dhunës online.

8.1 Колку се ефикасни државните институции како што се Министерството за внатрешни работи (МВР), Центарот за социјална работа (Ц...вањето на овој вид насилство? Оценете од 1-5
19 responses



Pyetja 8.1: Sa efektive janë institucionet shtetërore si p.sh. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe të tjerat në trajtimin e raportimit të këtij lloji dhune? Vlerësoni nga 1 deri në 5.

- 36,8% dhanë notën 3
- 31,6% dhanë notën 2
- 15,8% dhanë notën më të dobët 1
- 10,5% i vlerësuan institucionet me notën 4
- Vetëm 5,3% e dhanë notën më të lartë 5

Interpretimi i të dhënave:

Shumica e të anketuarve e vlerësuan efikasitetin e institucioneve shtetërore si mesatar ose nën mesatare. Vlerësimi më i zakonshëm - 3 nga 5 (36,8%) - tregon se **perceptimi për efikasitetin**


është i moderuar ose i paqëndrueshëm, ndërsa 31,6% dhanë notën 2, dhe 15,8% notën 1, **që tregon se ka pakënaqësi të qartë** dhe perceptim për joefikasitet të pothuajse gjysma e të anketuarve.

Vetëm një numër i vogël i pjesëmarrësve kishin vlerësim më pozitiv: 10,5% dhanë notën 4, ndërsa vetëm 5,3% i konsiderojnë institucionet si shumë efikase (notë 5).

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ka një **mungesë të përgjithshme besimi në institucione** siç janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qendra për Punë Sociale kur bëhet fjalë për trajtimin e raportimeve për dhunë me bazë gjinore online. Kjo e nxjerr në pah nevojën për reforma institucionale, **trajnime të specializuara, përmirësim të reagimit institucional** dhe ndërtim të besimit me komunitetet e prekura për të përmirësuar cilësinë e përgjigjeve institucionale.

9. Кои дополнителни ресурси или поддршка би ѝ помогнале на вашата организација да се справи со сајбер насилството поефикасно? Можни се повеќе одговори

19 responses



Pyetja 9: Cilat burime ose mbështetje shtesë do t'i ndihmonin organizatës suaj të përballet me dhunën kibernetike në mënyrë më efikase? (Mund të ketë disa përgjigje)

- 89,5% deklaruan se nevojiten më shumë mjete financiare për t'u ndihmuar viktimave të përballen në mënyrë më efikase me dhunën kibernetike.
- 78,9% kërkuan dispozita ligjore më të rrepta dhe më të qarta
- 68,4% kërkuan trajnime për aktivistët
- 68,4%, po ashtu, e theksuan nevojën për bashkëpunim më të mirë me organet e hetuesisë

Interpretimi i të dhënave:

Shumica dërmuese - pothuajse 90% - e identifikuan **mbështetjen financiare si nevojën më urgjente**, duke theksuar se edhe organizatat më të përkushtuara përballen me vështirësi në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe cilësore pa financim adekuat.

Një pjesë e konsiderueshme (78,9%) **e theksoi nevojën për dispozita ligjore më të qarta dhe më të rrepta**, gjë që tregon se ka shqetësime të vazhdueshme për shkak të paqartësive ligjore ose boshllëqeve në ligje që e dobësojnë mbrojtjen e viktimave dhe përgjegjësinë e autorëve.

Për më tepër, **ndërtimi i kapaciteteve të aktivistëve** (68,4%) u theksua gjithashtu si një prioritet, gjë që tregon se njihet rëndësia e punonjësve të trajnuar mirë për ofrimin e mbështetjes dhe avokimit efektiv.

Gjithashtu, 68,4% e të anketuarve e theksuan rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit me organet e hetuesisë, duke i vënë në dukje boshllëqet ekzistuese në koordinimin dhe besimin midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.

Shkurtimisht, të dhënat e pasqyrojnë **kërkesën komplekse për veprim - investime, reforma ligjore, zhvillim të aftësive dhe bashkëpunim ndërinstytucional** - me qëllim që të forcohet reagimi i përgjithshëm ndaj dhunës kibernetike dhe të shërbehen më mirë komunitetet e prekura.

Pyetja 9.1: Nëse në pyetjen e mëparshme u përgjigjët me "tjetër", mund të jepni koment.

Përgjigjet përfshijnë:

- Shkëmbim përvojash rajonale dhe globale mbi praktikën e mira
- Fushata për ngritjen e vetëdijes së publikut në temën: çfarë është dhuna kibernetike, si të njihet ajo, etj.
- Hapja e më shumë qendrave për mbështetjen e viktimave

Interpretimi i të dhënave:


Komentet shtesë e theksojnë nevojën për përpjekje më të gjera sistemike dhe edukative, të cilat do t'i plotësojnë burimet e përmendura më parë.

- Propozimi për **shkëmbimin rajonal dhe global të praktikave të mira** e thekson rëndësinë e të mësuarit dhe rrjetëzimit ndërkufitar, duke u mundësuar organizatave t'i përshtatin modelet e dëshmuara dhe t'i forcojnë qasjet e tyre strategjike.
- Kërkesat për fushata publike për informim e pasqyrojnë një qasje parandaluese, që synon të rrisë ngritjen e vetëdijes së publikut të gjerë për atë se çfarë është dhuna kibernetike dhe si të identifikohet - hapa kyç për ndërhyrjen e hershme dhe inkurajimin e kërimit të mbështetjes.
- Propozimi për hapjen e **më shumë qendrave për mbështetjen e viktimave** e thekson nevojën për shërbime të lokalizuara dhe të disponueshme, ku viktimat mund të marrin ndihmë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe ndihmën psiko-sociale dhe juridike.

Në fakt, këto komente e përforcojnë nevojën për strategji gjithëpërfshirëse - që e kombinojnë financimin, reformat ligjore, edukimin publik, bashkëpunimin ndërkufitar dhe shërbimet e lokalizuara për viktimat - për të luftuar në mënyrë efektive dhunën kibernetike.

10. Дали сметате дека социјалните мрежи имаат соодветни механизми за да се спротивстават на родово базираното сајбер насилство?

19 responses



Pyetja 10: A mendoni se rrjetet sociale kanë mekanizma adekuatë për t'iu kundërvënë dhunës kibernetike me bazë gjinore?

- 52,6% besojnë se rrjetet sociale nuk kanë mekanizma adekuatë
- 31,6% besojnë se pjesërisht kanë mekanizma adekuatë
- 15,8% besojnë se kanë mekanizma adekuatë

Interpretimi i të dhënave:

Të dhënat tregojnë se ka një **mungesë të qartë besimi në aftësitë e rrjeteve sociale** për të adresuar në mënyrë efektive dhunën kibernetike me bazë gjinore:

- Shumica (52,6%) konsiderojnë se rrjetet sociale nuk kanë **mekanizma adekuatë**, gjë që tregon se ka pakënaqësi të konsiderueshme me mjetet ekzistuese të raportimit, politikat e moderimit të përmbajtjeve ose reagimin e tyre ndaj raportimeve për abuzim.
- 31,6% i konsiderojnë platformat si pjesërisht efektive, gjë që mund të pasqyrojë progres në disa fusha, por edhe zbatim jo konsekuent, standarde të paqarta të komunitetit ose **disponueshmëri të kufizuar të funksioneve mbështetëse për përdoruesit e prekur**.
- Vetëm 15,8% konsiderojnë se rrjetet sociale kanë sisteme adekuate, gjë që tregon se përvojat pozitive me reagimin e platformave janë të kufizuara dhe nuk janë të përhapura gjerësisht.

Këto përgjigje e nxjerrin në pah **nevojën urgjente që kompanitë teknologjike ta përmirësojnë transparencën, mbrojtjen e përdoruesve dhe përgjegjshmërinë**, veçanërisht në adresimin e abuzimit me bazë gjinore online. Gjithashtu, kjo tregon për rolin e mundshëm të rregullatorëve dhe të shoqërisë civile në avokimin për reformat e rrjeteve sociale dhe forcimin e masave mbrojtëse.

Pyetja 11: Cilat ndryshime në politika ose ligje do të kishin ndikimin më të madh në kundërvënien ndaj dhunës kibernetike me bazë gjinore?

Përgjigjet përfshinin një sërë propozimesh:

- Dënime më të rrepta
- Përpjekje për ngritjen e vetëdijes publike, fushata dhe programe edukative (duke përfshirë lëndë në shkolla që nga moshën e hershme, të fokusuar në këtë temë dhe tema të ngjashme me të)

- Disa të anketuar e theksuan mungesën e ekspertizës ligjore për shkak të profesionit të tyre si artistë dhe aktivistë kulturorë.
- Përkufizime më të qarta ligjore të dhunës kibernetike, dënime më të rrepta për autorët, mbrojtje më e mirë e viktimave dhe bashkëpunim ndërsektorial.
- Zbatim i drejtësisë
- Dënime më të rrepta ("dënime rigoroze", "masa më drakoniane")
- Nevoja që dhuna kibernetike të përcaktohet qartë në ligje dhe të përfshihet si vepër e veçantë penale në Kodin Penal.
- Kërkesë për futjen e një ligji të posaçëm për viktimat e dhunës kibernetike
- Njohja se dhuna kibernetike është megjithatë dhunë dhe se duhet të trajtohet si i tillë, madje ndoshta edhe si kundërvajtje, me dënime përkatëse
- Hapa të qartë proceduralë për trajtimin e rasteve të ndryshme
- Rekomandim gjithëpërfshirës: Reformat ligjore duhet të përfshijnë përkufizime të qarta të të gjitha formave të dhunës kibernetike, duke i përfshirë edhe aspektet gjinore, sanksione më të rrepta, mekanizma më të shpejtë dhe më efektivë për raportim dhe hetim, detyrime për platformat digjitale që të ndërmarrin masa kundër përmbajtjeve të dëmshme, mbrojtje më të mirë për viktimat, duke përfshirë mbështetjen juridike dhe psikologjike, si dhe programe edukative/parandaluese, veçanërisht të dedikuara për të rinjtë dhe grupet e cënueshme.
- Disa theksuan se problemi kryesor nuk është mungesa e politikave, por zbatimi i dobët i tyre.
- Kërkesë e përsëritur për zbatimin e politikave dhe ligjeve ekzistuese

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet zbulojnë një konsensus të gjerë mbi nevojën urgjente për reforma ligjore dhe zbatim praktik në luftën kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore.

Dallohen disa tema kryesore:


1. Dënime më të rrepta: Shumë të anketuar kërkojnë dënime më të rrepta për autorët, duke besuar se ka nevojë për masa më të forta parandaluese për të zvogëluar abuzimin online.
2. Përkufizime të qarta ligjore: Vazhdimisht theksohet nevoja për përkufizime të qarta dhe të njohura ligjorisht të dhunës kibernetike dhe formave të saj me bazë gjinore - të cilat aktualisht perceptohen si të paqarta ose se mungojnë në legjislacionin ekzistues.
3. Boshllëqet në zbatim: Një numër i konsiderueshëm komentesh theksojnë se ligjet dhe politikat ekzistuese nuk zbatohen siç duhet, gjë që tregon se madje edhe korniza e mirë ligjore mund të jetë joefektive pa veprim nga institucionet.
4. Mbështetje e fokusuar të viktimat: Ekziston një avokim i fortë për përmirësimin e mbrojtjes së viktimave, duke përfshirë shërbime të specializuara, ndihmë juridike dhe mbështetje psikologjike, duke i njohur nevojat komplekse të të prekurve.
5. Parandalimi përmes edukimit: Disa përgjigje e theksojnë ndërhyrjen e hershme përmes shkollave dhe fushatave publike, gjë që tregon se ka një vizion proaktiv për parandalimin e dëmit përpara se të ndodhë.
6. Bashkëpunimi ndërsektorial: Konsiderohet se përgjigjet efektive kërkojnë koordinim ndërinstitutional midis organeve për zbatimin e ligjit, gjyqësorit, shërbimeve sociale dhe shoqërisë civile.

7. Përgjegjësia e platformave digjitale: Disa të anketuar e theksojnë rolin e kompanive teknologjike dhe propozojnë që ligjet t'i detyrojnë platformat të veprojnë kundër përmbajtjeve të dëmshme.

Shkurtimisht, të dhënat tregojnë se ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumështrësore - që do ta kombinojë qartësinë ligjore, zbatimin e fortë të ligjit, mbështetjen e viktimave, bashkëpunimin institucional, edukimin dhe përgjegjshmërinë e platformave - për luftë efektive kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore.

12. Дали мислите дека треба да има повеќе иницијативи или програми насочени кон охрабрување на младите луѓе/жени да пријавуваат сајбер насилство?

19 responses



Pyetja 12: A mendoni se duhet të ketë më shumë iniciativa ose programe që synojnë inkurajimin e të rinjve/grave që të raportojnë dhunën kibernetike?

- 100% e të anketuarve janë përgjigjur me “Po”.

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigja unanime pasqyron një bindje të fortë dhe të përbashkët mes të gjithë pjesëmarrësve: ekziston një nevojë e qartë dhe urgjente për më shumë iniciativa dhe programe që do t'i fuqizojnë të rinjtë, veçanërisht gratë, për të raportuar dhunën kibernetike.

Ky rezultat nxjerr në pah:


- Një nivel të lartë ndërgjegjësimi se përpjekjet aktuale janë ose të pamjaftueshme ose të papërshtatura për të rinjtë dhe gratë.
- Njohjen se raportimi i pamjaftueshëm vazhdon të jetë një sfidë e madhe - shpesh për shkak të frikës, stigmatizimit, mungesës së informacionit ose mosbesimit ndaj institucioneve.
- Mbështetjen kolektive për qasje parandaluese dhe edukative, të cilat do të mund të përfshinin rrjete bashkëmoshatarësh, kanale të sigurt raportimi, edukim në shkolla, mentorim dhe fushata publike.

Shkurtimisht, ky dakordim prej 100% u dërgon një mesazh të fortë hartuesve të politikave, edukatorëve dhe shoqërisë civile: fuqizimi i të rinjve dhe grave përmes programeve të synuara është thelbësor për të përmirësuar luftën kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore.

Anketë për psikologët/punonjësit socialë e aktivistëve të shoqërisë civile mbi dhunën kibernetike me bazë gjinore ndaj grave të reja

1. За каков тип организација работите?

13 responses



Pyetja 1: Për çfarë lloj organizate punoni?

- **61,5%** u përgjigjën se punojnë për organizatë që ofron **shërbime për mbështetje sociale**
- Të anketuarit e tjerë punojnë në **institucione që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje psiko-sociale**

Interpretimi i të dhënave:


Shumica e pjesëmarrësve (**61,5%**) janë të punësuar në organizata që ofrojnë **shërbime për mbështetje sociale**, gjë që tregon se shumica e të anketuarve janë të angazhuar në punë me komunitetin, me gjasë duke punuar drejtpërdrejt me grupet e cënueshme.

Pjesa tjetër punon në institucione që ofrojnë **mbështetje psiko-sociale**, si për shembull këshillim, shërbime për shëndetin mendor ose rehabilitim nga trauma, gjë që tregon se ka një fokus te **mirëqenia emocionale dhe psikologjike** e individëve, me gjasë duke i përfshirë edhe viktimat e dhunës kibernetike.

Kjo shpërndarje pasqyron **një sfond profesional të orientuar drejt mbështetjes**, ku shërbimet sociale dhe psiko-sociale luajnë role që e plotësojnë njëra tjetrën. Kjo sugjeron se të anketuarit kanë përvojë të vlefshme të linjës së parë në trajtimin e **ndikimeve komplekse të dhunës kibernetike** dhe janë në pozitë të mirë për t'i identifikuar boshllëqet në shërbime, sfidat institucionale dhe ndërhyrjet e nevojshme.

2. Колку долго работите како психолог/социјален работник

13 responses



Pyetja 2: Sa kohë keni që punoni si psikolog/punonjës social?

- **46,2%** u përgjigjën se kanë **më shumë se 8 vjet përvojë**
- **38,5%** kanë **4 deri në 7 vjet përvojë**
- **15,4%** kanë **1-3 vjet përvojë** si psikologë ose punonjës socialë

Interpretimi i të dhënave:

Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve janë **profesionistë me përvojë të madhe**, me ç'rast **pothuajse gjysma (46,2%)** punojnë në këtë fushë **mbi 8 vjet**. Kjo tregon se ka një bazë të fortë të **praktikuesve me përvojë** të cilët ka të ngjarë të kenë një kuptim të thellë për nevojat e grupeve të cenueshme dhe dinamikën e mbështetjes sociale ose psikologjike.

Përveç kësaj, **38,5%** kanë **nivel mesatar të përvojës së punës (4–7 vjet)**, gjë që tregon se ekziston një bazë e mirë profesionale që e plotëson grupin e veteranëve dhe kontribuon për një fuqi punëtore të fortë dhe të kualifikuar.

Vetëm **15,4%** kanë **1 deri në 3 vjet përvojë**, që me gjasë i përfaqëson profesionistët e rinj në këtë fushë – që potencialisht sjellin perspektiva të reja, por që gjithashtu kanë nevojë për mentorim dhe trajnim të vazhdueshëm.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ka **një komunitet profesional të fortë dhe me përvojë**, i cili është në pozicion të mirë për të trajtuar çështje komplekse siç është dhuna kibernetike dhe i aftë të ofrojë rekomandime të bazuara në informacione për përmirësime sistemore të shërbimeve mbështetëse.

3. Дали сте специјализирани за лекување и/или спречување и/или истражување траума или психолошки/социјални проблеми поврзани со сајбер насилство?

13 responses



Pyetja 3: A jeni të specializuar për trajtimin dhe/ose parandalimin dhe/ose hulumtimin e traumës ose problemeve psikologjike/sociale që lidhen me dhunën kibernetike?

- **61,5%** u përgjigjën se **nuk janë të specializuar** për trajtimin ose hulumtimin e traumës ose problemeve psikologjike/sociale që lidhen me dhunën kibernetike
- **23,1%** punojnë në **mbështetje të drejtpërdrejtë të viktimave**, prandaj **edhe e trajtojnë atë kur shfaqet**
- Vetëm **7,7%** e të anketuarve janë **posaçërisht të specializuar** në këtë fushë

Interpretimi i të dhënave:


Rezultatet nxjerrin në pah një **mungesë të konsiderueshme të specializimit** kur bëhet fjalë për trajtimin e **pasojeve psikologjike dhe sociale të dhunës kibernetike**:

- Një shumicë e madhe (**61,5%**) nuk kanë specializim formal në këtë temë, gjë që sugjeron se, megjithëse ata mund të punojnë me raste traumash ose probleme sociale në përgjithësi, ata **nuk ndihen mjaftueshëm të trajnuar ose të përgatitur** për t'u marrë me kompleksitetet specifike të abuzimit kibernetik.
- **23,1%** janë të përfshirë drejtpërdrejt në punën me viktimat, dhe megjithëse puna e tyre përfshin dhunën kibernetike **vetëm herë pas here**, duket se bëhet fjalë për një **qasje reaktive, në vend të qasjes së strukturuar ose të specializuar**.
- Vetëm **7,7%** kanë kaluar **trajnim ose specializim specifik**, gjë që tregon se ka **mungesë kritike të ekspertizës specifike** në këtë fushë.

Këto të dhëna tregojnë qartë se ka nevojë për **ngritje kapacitetesh, zhvillim profesional dhe programe të specializuara të trajnimit** për psikologët dhe punonjësit socialë. Duke pasur parasysh faktin se dhuna kibernetike vazhdon të rritet, njohuritë e specializuara janë thelbësore për parandalimin efektiv, ndërhyrjen dhe kujdesin që e merr parasysh traumën.

4. Дали жртвите со кои работите пријавиле дека доживеале родово базирано сајбер насилство?

13 responses



Pyetja 4: A kanë raportuar viktimat me të cilat punoni se kanë përjetuar dhunë kibernetike me bazë gjinore?

- **38,5%** thanë se viktimat **nuk kanë raportuar përvoja të tilla**
- **23,1%** thanë se viktimat kanë **raportuar** një përvojë të tillë
- **23,1%** thanë **se herë pas here hasin në raste të tilla**
- **15,4%** deklaruan se viktimat **nuk mund ta njohin atë si dhunë**

Interpretimi i të dhënave:


Përgjigjet tregojnë se **dhuna kibernetike me bazë gjinore shpesh nuk raportohet ose nuk njihet nga vetë viktimat:**

- Grupi më i madh (**38,5%**) deklaroi se **nuk janë raportuar raste të tilla**, gjë që mund të tregojë se ka **raportim të pamjaftueshëm, mungesë ndërgjegjësimit, ose hezitim për të raportuar** për shkak të frikës ose stigmatizimit.
- Një grup më i vogël, por domethënës (**23,1%**) konfirmoi se viktimat **kanë raportuar** incidente të tilla, gjë që tregon se njerëz të caktuar janë të vetëdijshëm për dhunën kibernetike dhe se janë të gatshëm të flasin hapur për të.
- Një përqindje e njëjtë e të anketuarve, **23,1%**, deklaroi se **herë pas here** hasin në raste të tilla, gjë që mund të tregojë se ka **njohje ose dokumentim të herë pas hershëm**, me gjasë në varësi të kontekstit ose seriozitetit të situatës.
- Në mënyrë shqetësuese, **15,4%** e të anketuarve theksuan se viktimat **nuk e njohin dhunën kibernetike si një formë dhune**, gjë që tregon se ka **një boshllëk serioz në njohuri dhe nevojë për edukim dhe ngritje të vetëdijes**.

Në përgjithësi, të dhënat e theksojnë rëndësinë e **trajnimit, si të profesionistëve ashtu edhe të publikut, për ta njohur dhe për t'iu përgjigjur dhunës kibernetike**, veçanërisht kur bëhet fjalë për atë me bazë gjinore. Nevojiten **mekanizma më të mirë për identifikim, verifikim dhe raportim** për të siguruar mbështetje dhe mbrojtje adekuate për personat e prekur.

5. Koi se најчестите психолошки ефекти или социјални проблеми што сте ги забележале кај жртвите? Можни се повеќе одговори

13 responses



Pyetja 5: Cilat janë efektet më të zakonshme psikologjike ose problemet sociale që i keni vërejtur te viktimat? (Mund të ketë disa përgjigje)

- **92,3%** e kanë përmendur **ankthin** si pasojë më të zakonshme psikologjike
- **84,6%** kanë raportuar **depresion, vetëbesim të ulët, stigmatizim dhe frikë nga gjykimi i shoqërisë**
- **61,5%** kanë vënë re **izolim social**
- **53,8%** kanë raportuar raste të **çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD)**

Interpretimi i të dhënave:


Përgjigjet i zbulojnë **pasojat serioze emocionale dhe sociale** që dhuna kibernetike me bazë gjinore i ka te viktimat:

- **Ankthi (92,3%)** dallohet si **pasojë psikologjike më e shpeshtë**, gjë që tregon se ka frikë të vazhdueshme, vigjilencë të shtuar dhe stres emocional tek individët e prekur.
- Një përqindje shumë e lartë (**84,6%**) gjithashtu raportoi **depresion, vetëbesim të ulët, stigmatizim dhe frikë nga gjykimi**, gjë që tregon se ka **ndikim të thellë në shëndetin mendor dhe identitetin social të viktimave**. Ky kombinim mund të çojë në tërheqje, humbje të motivimit dhe ngurrim për të kërkuar ndihmë.
- **Izolimi social (61.5%)** duket se është një reagim i shpeshtë, ndoshta si rezultat i turp, mungesës së mbështetjes ose frikës nga ekspozimi i përsëritur, gjë që **e thellon më tej stresin emocional dhe ndjenjën e përjashtimit**.
- Më shumë se **gjysma e të anketuarve (53,8%)** kanë vërejtur simptoma të **çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD)**, gjë që sugjeron se te shumë viktime, ndikimi i dhunës kibernetike shkon përtej dëmit të menjëhershëm emocional dhe mund të përshkallëzohet në **traumë psikologjike afatgjatë**.

Shkurtimisht, të dhënat theksojnë qartë se dhuna kibernetike **nuk është një problem i vogël apo i izoluar**, por **një fenomen serioz me pasoja afatgjata** mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien sociale të viktimave. Kjo e përforcon nevojën për **shërbime të specializuara të bazuara në një qasje që është e ndjeshme ndaj traumës, mbështetje psikologjike dhe edukim publik** për ta zvogëluar stigmatizimin dhe për të nxitur rikuperimin.

6. Како би ја оцениле сериозноста на психолошкиот стрес предизвикан од сајбер насилство?

13 responses



Pyetja 6: Si do ta vlerësonit seriozitetin e stresit psikologjik të shkaktuar nga dhuna kibernetike?

- **53,8%** e vlerësuan si **situatë serioze**
- **46,2%** thanë se **varet nga rasti**

Interpretimi i të dhënave:


Më shumë se gjysma e të anketuarve (**53,8%**) e përjetojnë **stresin psikologjik të shkaktuar nga dhuna kibernetike si një problem serioz**, gjë që tregon se ka një konsensus të fortë profesional se barra emocionale dhe mendore mbi viktimat **nuk duhet nënvlerësuar**. Kjo pasqyron një kuptim të qartë se dhuna kibernetike mund të shkaktojë **dëme të thella dhe të qëndrueshme**, shpesh të krahasueshme ose edhe më të rënda se ndikimi i dhunës jashtë internetit.

Në të njëjtën kohë, **46,2%** theksuan se **serioziteti varet nga rasti.**, gjë që sugjeron se **konteksti, kohëzgjatja dhe intensiteti** e abuzimit - si dhe sfondi personal dhe qëndrueshmëria e viktimës - luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e ndikimit psikologjik.

Së bashku, përgjigjet e nxjerrin në pah faktin se **dhuna kibernetike është një problem serioz i shëndetit mendor**, dhe, megjithëse efektet e saj mund të ndryshojnë nga personi në person, ato shpesh **arrijnë nivele serioze që kërkojnë ndërhyrje profesionale**. Kjo e thekson nevojën për **mbështetje të individualizuar**, qasje në **burime të shëndetit mendor**, dhe **njohje më të madhe të dhunës kibernetike si një formë traume** në kuadër të sistemeve shëndetësore dhe të mbështetjes sociale.

7. Дали жертвите често бараат професионална психолошка/социјална поддршка?

13 responses



Pyetja 7: A kërkojnë viktimat shpesh mbështetje profesionale psikologjike/sociale?

- **69,2%** u përgjigjën se viktimat kërkojnë ndihmë profesionale **vetëm kur situata përkeqësohet**
- **23,1%** thanë se viktimat **nuk kërkojnë ndihmë fare**
- Vetëm **7,7%** thanë se viktimat **kërkojnë mbështetje në mënyrë proaktive**

Interpretimi i të dhënave:

Gjetjet zbulojnë një model shqetësues të **kërkimit të vonuar ose të kufizuar të ndihmës** nga viktimat e dhunës kibernetike:

- Shumica (**69,2%**) deklarojnë se viktimat **kërkojnë ndihmë profesionale vetëm kur situata përkeqësohet ndjeshëm**, gjë që tregon se shumë njerëz vuajnë në heshtje derisa të arrijnë një pikë kritike. Kjo vonesë mund të jetë si pasojë e **stigmatizimit, frikës se nuk do të besohen ose mungesës së ndërgjegjësimit** për shërbimet që ofrohen.
- Pothuajse një e katërta (**23,1%**) deklaruan se viktimat **nuk kërkojnë ndihmë fare**, gjë që mund të tregojë se bëhet fjalë për **pengesa serioze, të tilla si mosbesimi në institucione, mungesa e qasjes ose ndjenja e turpfit**.
- Në mënyrë shqetësuese, vetëm **7,7%** theksuan se viktimat **kërkojnë mbështetje psikologjike ose sociale ni në mënyrë proaktive**, gjë që tregon se ka një **nivel të ulët të ndërhyrjes së hershme**, e cila është thelbësore për zbutjen e pasojave afatgjata mbi shëndetin mendor.

Në përgjithësi, të dhënat e theksojnë nevojën për:


- **Përmirësimin e vetëdijes publike** mbi rëndësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse
- **Zvogëlimi i stigmës** që lidhet me kërkimin e ndihmës
- **Qasje proaktive dhe strategji për ndërhyrjeje të hershme** nga profesionistët dhe institucionet

Kjo mund të kontribuojë për krijimin e një mjedisi më mbështetës ku viktimat ndihen të sigurta dhe të inkurajara të kërkojnë ndihmë **përpara se situata të bëhet kritike**.

8. Koi se главните пречки што ги спречуваат жртвите да добијат психолошка поддршка?

Можни се повеќе одговори

13 responses



Pyetja 8: Cilat janë pengesat kryesore që i pengojnë viktimat të marrin mbështetje psikologjike?

(Mund të ketë disa përgjigje)

- Pengesa kryesore janë **mungesa e vetëdijes – 61,5%**
- **Shërbimet e specializuara të kufizuara dhe mungesa e burimeve financiare – 53,8%**
- **Stigma sociale – 46,2%**
- **Mangësitë në dispozitat ligjore – 46,2%**
- **Pengesat institucionale – 23,1%**
- **Viktimat nuk e dinë mekanizmin e raportimit – 38,5%**
- **Arsye të tjera 15,4%**

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet tregojnë **një grup të gjerë dhe të ndërlikuar pengesash** që i pengojnë viktimat e dhunës kibernetike të marrin mbështetjen e nevojshme psikologjike:

- **Mungesa e vetëdijes (61,5%)** dallohet si problemi më i përmendur, që tregon se shumë viktimat **ndoshta as nuk e dinë se ka mbështetje ose kur/si ta kërkojnë atë.**
- **Shërbimet e specializuara të kufizuara dhe mungesa e burimeve financiare (53,8%)** tregojnë se ka probleme strukture në sistemin të mbështetjes, me **kapacitet të pamjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat specifike** të viktimave të dhunës kibernetike.
- **Stigma sociale (46,2%)** vazhdon të jetë një pengesë e fuqishme, pasi viktimat mund të kenë frikë se do të akuzohen, gjykohen ose nuk do të merren seriozisht, veçanërisht në komunitetet më konservatore apo të mbyllura.
- **Mangësitë në legjislacion (46,2%)** e vështirësojnë më tej qasjen në drejtësi dhe mbrojtje, duke e bërë të vështirë njohjen formale ose procedimin e përvojave të viktimave.
- **Pengesat institucionale (23,1%) dhe mungesat e informacionit për mekanizmat e raportimit (38,5%)** sugjerojnë se sistemet për kërkimin e ndihmës janë **të paqarta, të paarritshme ose nuk komunikohen në mënyrë efektive.**

- Një pjesë më e vogël (**15,4%**) kanë zgjedhur arsye “**të tjera**” që mund të përfshijnë faktorë personalë, kulturorë ose që lidhen me situatat, e që nuk mbulohen nga opsionet e ofruara.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se **pengesat, si në nivel individual ashtu edhe në atë sistemor**, i pengojnë viktimat të marrin mbështetje psikologjike. Për t'i kapërcyer ato, është e nevojshme:

- **Të zbatohen fushata gjithëpërfshirëse për ngritjen e vetëdijes së publikut**
- **Të zgjerohen shërbimet e specializuara**
- **Të zvogëlohet stigma**
- **Të përmirësohet qartësia ligjore**
- **Të sigurohet që institucionet të jenë të arritshme, të përgjegjshme dhe të koordinuara mirë**

Vetëm përmes **qasjeve të integruara dhe të përqendruara te viktima** këto pengesa mund të reduktohen në mënyrë efektive

Pyetja 8.1: Nëse në pyetjen e mëparshme u përgjigjët me "Tjetër", mund të jepni koment.
(13 përgjigje)

Shembuj të përgjigjeve:

- **Nuk u besojnë institucioneve**
- **Turpi është arsyeja më e shpeshtë për mosraportim**
- **Shpesh ndihen të turpëruar para shoqërisë**

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet e hapura të të anketuarve i përforcojnë gjetjet e mëparshme dhe ofrojnë një pasqyrë më të thellë të **pengesave emocionale dhe sociale** që i pengojnë viktimat të kërkojnë mbështetje psikologjike:

- **Mosbesimi në institucione** vë në dukje një **mungesë kritike të besimit në sistem**, që mund të burojë nga përvojat e mëparshme negative, perceptimi se ka mungesë të veprimit ose bindja se institucionet nuk do ta marrin problemin me seriozitet.
- **Turpi** shfaqet si një **pengesë emocionale dominuese**, me ç'rast disa komente i theksojnë **grykimin e shoqërisë dhe fajësimin e viktimës** si pengesa kryesore. Kjo tregon se normat kulturore dhe qëndrimet shoqërore ende **i heshtin viktimat**, veçanërisht kur bëhet fjalë për dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale.


Këto përgjigje e theksojnë **nevojën për ndërtimin e besimit në sistem dhe ndryshim kulturor**, duke përfshirë:

- **Transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve**
- **Mekanizma raportimi konfidencialë dhe të ndjeshëm ndaj viktimave**
- **Fushata për edukimin e komunitetit** për të zvogëluar stigmën dhe për të normalizuar kërkimin e ndihmës

Shkurtimisht, përveç pengesave ligjore ose logjistike, **presionet psikologjike dhe sociale luajnë një rol të rëndësishëm në heshtjen e viktimave**. Për t'i kapërcyer ato, nevojiten jo vetëm reforma strukturore, por edhe **përpjekje të thella dhe të qëndrueshme në edukimin publik, zhvillimin e empatisë dhe mbështetjen e komunitetit**.

9. Koi tipi i intervencioneve ju shtojte më efikasitet për viktimat e dhunës kibernetike?

13 responses



Pyetja 9: Cilat lloje të ndërhyrjeve i konsideroni më efikase për viktimat e dhunës kibernetike?

- **84,6%** i konsiderojnë **grupe mbështetëse** si ndërhyrje më efektive
- **61,5%** thanë se **terapia njohëse dhe e sjelljes (CBT)** është më e dobishme
- **15,4%** shënuan **këshillimin në rast krize**
- **23,1%** zgjedhën **terapinë online**
- **23,1%** përzgjedhën **trajnimin ose mentorim**
- **15,4%** theksuan **aktivitetet me luajtje të roleve dhe zhvillimin e aftësive**
- **15,4%** gjithashtu i përmendën **lojërat dhe teknikat për gamifikim**

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet tregojnë një preferencë të fortë për **qasjet e bazuara në komunitet dhe ato terapeutike** për të mbështetur viktimat e dhunës kibernetike:


- **Grupet mbështetëse (84,6%)** janë më të rekomanduara, gjë që tregon se **ndarja e përvojave dhe lidhja e ndërsjellë me bashkëmoshatarët** konsiderohen mjete të fuqishme për të zvogëluar izolimin dhe për të rritur ndjenjën e fuqizimit midis viktimave.
- **Terapia njohëse dhe e sjelljes (CBT) (61,5%)** njihet për qasjen e saj të strukturuar në **që i ndihmon viktimat të kapërcejnë traumën, të zvogëlojnë ankthin ose depresionin dhe të rifitojnë ndjenjën e kontrollit mbi jetën e tyre.**
- **Këshillim në raste krize (15,4%),** megjithëse është zgjedhur më rrallë, e pasqyron nevojën për **stabilizim emocional të menjëhershëm** në situata akute.
- **Terapia online (23,1%) dhe trajnimi/mentorimi (23,1%)** po fitojnë gjithnjë e më shumë mbështetje si **metoda që janë të adaptueshme, lehtësisht të arritshme dhe që ofrojnë udhëzime/mbështetje,** dhe janë veçanërisht të rëndësishme për viktimat që mund të hezitojnë ose nuk mund të kërkojnë ndihmë personale.
- **Lojërat me role (15,4%) dhe gamifikimi (15,4%)** ishin më pak të zgjedhura, por tregojnë një gatishmëri për përdorimin e **strategjive krijuese dhe përfshirëse për mësim dhe fuqizim,** dhe janë veçanërisht të zbatueshme në ndërhyrjet e fokusuara te të rinjtë.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se **kombinimi i mbështetjes emocionale, mjeteve terapeutike dhe metodave inovative të përfshirjes** konsiderohet si më efektiv. Theksohet

rëndësia e **qasjes holistike**, që është e ndjeshme ndaj traumës dhe modeleve të ndërhyrjes që janë të përqendruara te viktimat në trajtimin e dhunës kibernetike.

10. Дали сметате дека има доволно свесност меѓу професионалците за психолошкото влијание на сајбер насилството?

13 responses



Pyetja 10: A mendoni se ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm midis profesionistëve për ndikimin psikologjik të dhunës kibernetike?

- **69,2%** u përgjigjën se ka **ndërgjegjësim të pjesshëm**
- **30,8%** mendojnë se ka **ndërgjegjësim** midis profesionistëve për ndikimin psikologjik

Interpretimi i të dhënave:

Rezultatet tregojnë se **ka ndërgjegjësim midis profesionistëve për ndikimin psikologjik të dhunës kibernetike, por se ky ndikim është i kufizuar:**

- Shumica (**69,2%**) theksoi se **ndërgjegjësimi ekziston vetëm në një masë të caktuar**, që tregon se ka **boshllëqe në kuptimin, trajnimin ose dhënien përparësi** që i kushtohet dhunës kibernetike si një problem serioz i shëndetit mendor.
- Vetëm **30,8%** konsiderojnë se profesionistët **janë mjaftueshëm të vetëdijshëm**, gjë që, megjithëse inkurajuese, njëkohësisht tregon se **nevojitet një zhvillim profesional më gjithëpërfshirës dhe më i gjerë**.


Këto të dhëna e theksojnë nevojën për:

- **Edukim dhe trajnim të vazhdueshëm** të psikologëve, punonjësve socialë, edukatorëve dhe stafit institucional
- **Përfshirjen e traumave që lidhen me dhunën kibernetike** në programet mësimore për shëndetin mendor dhe punën sociale
- **Integrim më të fortë të temës së dhunës digjitale** në kodet e etikës profesionale dhe protokollet e nivelit kombëtar për ofrimin e shërbimeve.

Shkurtimisht, ndonëse është bërë njëfarë përparimi, **mendimi i shumicës është se ndërgjegjësimi midis profesionistëve ende nuk është në nivelin e kërkuar**, duke e theksuar rëndësinë e **ndërtimit të kapaciteteve për të siguruar reagim në kohë, të informuar dhe të ndjeshëm ndaj viktimave**.

11. Какво е вашето искуство во соработката со државните институции за превенција и пријавување на онлајн насилство?

13 responses



Pyetja 11: Cila është përvoja juaj në bashkëpunimin me institucionet shtetërore për parandalimin dhe raportimin e dhunës online?

- **38,5%** u përgjigjën se përvoja e tyre ka qenë **pozitive**
- **30,8%** thanë se nuk kanë pasur **përvojë të drejtpërdrejtë** me institucionet
- **30,8%** thanë se përvoja e tyre ka qenë **deri diku pozitive**

Vërehet se disa nga të anketuarit punojnë vetë brenda institucioneve, gjë që mund ta shpjegojë nivelin relativisht të lartë të kënaqësisë me bashkëpunimin.


Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet tregojnë se ka një **perceptim përgjithësisht të favorshëm për bashkëpunimin me institucionet shtetërore**, megjithëse është e rëndësishme që rezultatet të interpretohen me kujdes:

- **38,5%** kanë raportuar **përvoja pozitive**, gjë që tregon se kur bashkëpunimi ekziston, ai shpesh është efikas - ndoshta për shkak të protokolleve të qarta, mirëkuptimit të ndërsjellë ose qasjes institucionale.
- Një numër i barabartë i të anketuarve (**30,8%**) ose **nuk kanë pasur bashkëveprim të drejtpërdrejtë** ose kanë pasur **përvoja deri diku pozitive**, duke sugjeruar se në shumë raste **bashkëpunimi është ose i kufizuar ose është ende në zhvillim e sipër**.
- Fakti që **disa të anketuar punojnë në institucione** mund të shpjegojë nivelin më të lartë të kënaqësisë, sepse aktorët e brendshëm zakonisht kanë **qasje më të mirë, ndërgjegjësime më të madh dhe ndikim më të drejtpërdrejtë** brenda sistemit.

Në përgjithësi, megjithëse të dhënat tregojnë se ka **potencial për bashkëpunim produktiv**, ato gjithashtu zbulojnë se ka **hapësirë për përmirësimin e qasjes, komunikimit ndërsektorial dhe përfshirjes së profesionistëve jashtë institucioneve**. Forcimi i partneriteteve institucionale, veçanërisht me punonjësit e vijës së parë të shoqërisë civile, mund **ta përmirësojë koordinimin, besimin dhe reagimin efektiv** në përballjen me dhunën online.

11.1 Колку се ефикасни државните институции како што се Министерството за внатрешни работи (МВР), Центарот за социјална работа (Ц...вањето на овој вид насилство? Оценете од 1-5
13 responses



Pyetja 11.1: Sa efektive janë institucionet shtetërore si p.sh. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe të tjerat në trajtimin e raportimit të këtij lloji dhune? Vlerësoni nga 1 deri në 5.

- **53,8%** e vlerësuan punën e institucioneve me notën **4**
- **23,1%** dhanë notën më të lartë **5**

Përsëri, duke marrë parasysh disa nga të anketuarit punojnë vetë brenda institucioneve, kjo mund t'i shpjegojë nivelet më të larta të kënaqësisë nga bashkëpunimi me institucionet shtetërore.

Interpretimi i të dhënave:

Shumica e të anketuarve shprehën **nivele të larta besimi në efikasitetin e institucioneve shtetërore** gjatë përballjes me dhunën online:

- **Më shumë se gjysma (53,8%)** e vlerësuan punën e institucioneve me notën **4 nga 5**, gjë që tregon se ata e perceptojnë reagimin institucional si **përgjithësisht efektiv, por me hapësirë për përmirësim**.
- Një përqindje e konsiderueshme prej **23,1%** dhanë notën më të lartë **5**, gjë që tregon se ka **kënaqësi të lartë dhe besim të fortë** në mënyrën se si këto institucione i trajtojnë raportimet dhe ofrimin e mbështetjes.

Megjithatë, ky **perceptim pozitiv duhet të interpretohet me kujdes** - fakti që **një pjesë e të anketuarve janë përfaqësues të institucioneve** mund të ndikojë në këto vlerësime të favorshme, **duke reflektuar më perspektivat e brendshme, se sa përvojat e përdoruesve të jashtëm**.

Edhe pse të dhënat tregojnë se ka **perceptimi për efikasitet të institucioneve**, veçanërisht nga njerëzit brenda sistemit, ata gjithashtu e theksojnë nevojën për:

- **Vlerësim objektiv të shërbimeve nga perspektiva e viktimave dhe punonjësve të vijës së parë**
- **Përmirësime të vazhdueshme në kohën e reagimit, kujdesin ndaj viktimave dhe koordinimin ndërinstitutional**
- **Përpjekje të shtuara për të ndërtuar besim dhe transparencë më të gjerë edhe përtej qarqeve institucionale**

Shkurtimisht, megjithëse besimi i brendshëm është i lartë, konfirmimi më i gjerë nga palët e ndryshme të interesuara mbetet thelbësor për të siguruar **një reagim institucional vërtet efektiv dhe të besueshëm** ndaj dhunës kibernetike.

Pyetja 12: Cilat burime ose politika shtesë do të ndihmonin në përmirësimin e mbështetjes psikologjike/sociale për viktimat?

Shembuj të përgjigjeve:

- Më shumë trajnime për punonjësit dhe fokus më i fortë në parandalim
- Ndalim për përdorimin e telefonave celularë në shkollë (të lejohen vetëm gjatë transportit për në/nga shkollë); kufizim për përdorimin e aplikacioneve si TikTok për përdoruesit mbi 18 vjeç; kërkesa për mbikëqyrje prindërore, me gjopa financiare për mosrespektim - si një mënyrë për të ngritur vetëdijen për atë se çfarë është sjellje e pranueshme në internet.
- Mbështetje financiare për viktimat që të mund të përballojnë psikoterapi afatgjatë
- Dhuna online duhet të jetë **e ndaluar me ligj** dhe të trajtohet në mënyrë të barabartë me format e tjera të dhunës (fizike, psikologjike, ekonomike, seksuale, etj.)
- Psikologët në institucionet shtetërore duhet të jenë në gjendje të **përqendrohen në rolin e tyre profesional** pa u ngarkuar me detyra administrative
- Qasje në psikoterapistë
- Aktivitete parandaluese duke filluar që nga fëmijëria e hershme; **dënime të ashpra për autorët**
- Mundësi për punësim dhe për të ardhura; **mjete për banim** për viktimat
- Më shumë programe trajnimi
- Mbulim mediatik dhe informim publik
- Edukim më i mirë, më shumë anketa, **përfshirje e të rinjve në projekte**, ligjërata dhe **shpjegim i qartë i seriozitetit dhe pasojave** të dhunës kibernetike
- Fushata për ngritjen e vetëdijes

Interpretimi i të dhënave:

Përgjigjet tregojnë se ka një **kuptim gjithëpërfshirës për nevojat e ndryshme** të viktimave të dhunës kibernetike, duke i theksuar edhe **përmirësimet sistemore dhe ndërhyrjet praktike**.

Temat kryesore përfshijnë:

- **Ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnime:** Disa përgjigje e theksojnë nevojën për **më shumë trajnime për profesionistët**, si në aspektin e njohurive teknike ashtu edhe të kujdesit që është i ndjeshëm ndaj traumës. Kjo e pasqyron dëshirën për përmirësimin e **përgatitjes dhe ekspertizës së institucioneve**.
- **Parandalimin e hershëm dhe edukimin e të rinjve:** Në disa komente kërkohen **masa parandaluese që në moshë të re**, përmes **politikave shkollërore, edukimit publik**, dhe **programeve për përfshirjen e të rinjve**. Këto masa synojnë të nxisin **përgjegjësinë dhe ndërgjegjësimin digjital**.
- **Reformat ligjore dhe politike:** Ka mbështetje për **njohjen ligjore të dhunës online, si formë po aq serioze sikurse edhe format e tjera të abuzimit**, me kërkesa për **legjislacion më të qartë dhe dënime më të rrepta** për autorët.
- **Infrastrukturën për shëndetin mendor:** Të anketuarit e theksojnë nevojën për **ndihmë financiare për viktimat, qasje te psikoterapistët** dhe t'u mundësohet **psikologëve në**


institucionet publike që t'i përkushtohen punës së vërtetë terapeutike, në vend të detyrave administrative.

- **Përgjegjësinë e familjeve dhe të institucioneve:** Sugjerimet përfshijnë **përgjegjësi për mbikëqyrje prindërore**, kufizime të përmbajtjeve të dëmshme digjitale dhe masa disiplinore për neglizhencë ndaj përgjegjësisë, gjë që e potencon **rolin e familjes dhe të shkollës** në parandalim.
- **Mbështetjen ekonomike dhe sociale:** Punësimi, të ardhurat personale dhe ndihma për strehim u identifikuan gjithashtu si thelbësore, duke pasur parasysh se viktimat shpesh kanë nevojë për **burime për rimëkëmbje të gjithanshme**, e jo vetëm për këshillim.
- **Ndërgjegjësimin publik:** Në përgjigjet kërkohet **mbulim mediatik, fushata dhe anketa në komunitet** për të rritur kuptimin dhe dukshmërinë e problemit.

Shkurtimisht, komentet tregojnë se **përmirësimi i mbështetjes për viktimat e dhunës kibernetike kërkon ndërhyrje sistemore, të përbashkëta dhe individuale** — duke filluar nga reformat ligjore dhe ndryshimet institucionale, deri te përfshirja e familjeve, edukimi dhe qasja në shërbimet e shëndetit mendor.

13. Дали мислите дека треба да има повеќе иницијативи или програми насочени кон охрабрување на младите луѓе/жени да пријавуваат сајбер насилство?

13 responses



Pyetja 13: A mendoni se duhet të ketë më shumë iniciativa ose programe që synojnë inkurajimin e të rinjve/grave që të raportojnë dhunën kibernetike?

- **84,6%** u përgjigjën me **“Po”**, se duhet të ketë më shumë iniciativa,
- **15,4%** thanë se **nuk e dinë** a duhet të ketë më shumë iniciativa të tilla

Interpretimi i të dhënave:

Shumica dërmuese (**84,6%**) e të anketuarve e mbështesin nevojën për krijimin e **më shumë iniciativave dhe programeve** që i inkurajojnë **të rinjtë dhe gratë ta raportojnë dhunën kibernetike**. Kjo tregon se ka një njohje të fortë të rëndësisë së **fuqizimit, ngritjes së vetëdijes dhe ofrimit të mekanizmave të arritshëm për raportim** — veçanërisht për grupet që janë më të cenueshme ndaj abuzimit online.

Përqindja prej **15,4%** që **nuk janë të sigurt** mund të tregojë nevojën për **më shumë informacion, hulumtime ose qartësi** për atë se si këto programe mund të përpilohen dhe të zbatohen në mënyrë efektive.

Në përgjithësi, këto të dhëna e konfirmojnë **konsensusin e gjerë** midis profesionistëve për rëndësinë e **ndërhyrjeve proaktive, të ndjeshme ndaj të rinjve dhe gjinisë**, veçanërisht ato që:

- **E promovojnë edukimin digjital dhe njohuritë ligjore**
- **E zvogëlojnë stigmën që lidhet me raportimin**
- **Sigurojnë mekanizma të sigurta, konfidenciale të raportimit që do të ofrojnë mbështetje për viktimat**

Kjo e përforcon nevojën për **strategji sistemore për informim dhe parandalim** që i përfshijnë drejtpërdrejt të rinjtë dhe gratë si pjesë e **reagimit gjithëpërfshirës ndaj dhunës kibernetike**.

Përfundime

1. Profili i të anketuarve

Shumica e të anketuarve vijnë nga mjedise profesionale në shërbimet sociale dhe psiko-sociale, dhe shumë prej tyre kanë përvojë të pasur në fushat e tyre. Pavarësisht kësaj baze të fortë, pak prej tyre kanë ndjekur trajnime të specializuara që lidhen konkretisht me traumat e shkaktuara nga dhuna kibernetike. Kjo tregon se ka nevojë për zhvillim më të thellë profesional në pjesën ku ka ndërthurje të abuzimit digjital dhe shëndetit mendor.

2. Angazhim në rritje, por i pabarabartë

Aktivizmi kundër dhunës kibernetike me bazë gjinore është në rritje, por përfshirja mbetet e pabarabartë. Shumë viktimë vazhdojnë të vuajnë në heshtje, shpesh herë për shkak të ndjenjës së turpit, stigmës shoqërore ose thjesht për shkak të mungesës së vetëdijes se ajo që e përjetojnë paraqet dhunë kibernetike. Këto pengesa e pengojnë raportimin në kohë dhe e vonojnë qasjen në mbështetje.

3. Format më të shpeshta të dhunës kibernetike

Ndër llojet më të raportuara të dhunës kibernetike janë gjuha e urrejtjes, ngacmimi online, shpërndarja e fotografive pa pëlqim dhe përndjekja kibernetike. Këto forma të abuzimit jo vetëm që janë të përhapura gjerësisht, por edhe tepër të dëmshme, duke shkaktuar pasoja të rënda emocionale dhe sociale për personat e prekur.

4. Boshllëqe në reagimin ligjor dhe institucional

Edhe pse është arritur një përparim i caktuar në bashkëpunimin institucional, të anketuarit ende i konsiderojnë ligjet ekzistuese si kryesisht joefikase ose vetëm pjesërisht adekuate. Ekziston një nevojë urgjente për përkufizime më të qarta ligjore të dhunës kibernetike, mekanizma më të fortë për zbatimin e ligjeve dhe mbrojtje më e fortë për viktimat. Mospërputhja në reagimet e institucioneve mbetet një shqetësim kyç.

5. Pasojat psikologjike janë serioze

Barra psikologjike e dhunës kibernetike është e pamohueshme. Viktimat shpesh raportojnë se përjetojnë ankth, depresion, çrregullim të stresit post-traumatik (PTSD), izolim social dhe një rënie të ndjeshme të vetëbesimit. Është alarmante që shumica e njerëzve kërkojnë mbështetje psikologjike ose sociale vetëm kur situata bëhet e padurueshme, e jo si një masë parandaluese ose si ndërhyrje e hershme.

6. Pengesat për mbështetje

Viktimat përballen me pengesa të shumta që e vështirësojnë qasjen në mbështetjen që u nevojitet. Këtu bëjnë pjesë mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit për shërbimet që janë në dispozicion, mungesa e programeve të specializuara të mbështetjes që janë të financuara në mënyrë adekuate, si dhe stigmatizimi i përhapur gjerësisht nga shoqëria që i dekurajon viktimat të flasin hapur. Mosbesimi në institucione dhe mekanizmat e paqarta ose të paarritshme të raportimit e ndërlikojnë më tej problemin.

7. Ndërhyrjet efektive

Grupet mbështetëse dhe terapia njohëse dhe e sjelljes (CBT) konsiderohen si ndërhyrje më efikase për viktimat. Megjithatë, qasjet më të reja - të tilla si terapia online, programet e

mentorimit, e madje edhe teknikat e gamifikimit - po fitojnë popullaritet dhe ofrojnë mundësi premtuese për përfshirje, veçanërisht të popullatës më të re.

8. Nevoja për programe të synuara

Ekziston një konsensus i qartë për më shumë iniciativa që i inkurajojnë drejtpërdrejt të rinjtë dhe gratë që të raportojnë dhunën kibernetike. Këto programe duhet të fillojnë herët dhe të integrohen në sistemet arsimore dhe fushatat për ngritjen e vetëdijes publike. Ndërtimi i një kulture të njohjes, mbështetjes dhe parandalimit proaktiv është me rëndësi thelbësore për fuqizimin e viktimave dhe zvogëlimin e dëmit afatgjatë të dhunës kibernetike.

Rekomandime

Rekomandime për veprim: Forcimi i reagimit ndaj dhunës kibernetike me bazë gjinore

Profesionistët që punojnë në fushën e parandalimit të dhunës kibernetike dhe mbështetjes së viktimave kanë shprehur nevojën urgjente për veprime gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara në disa fusha kyçe. Më e rëndësishme është nevoja për **ligje më të rrepta dhe mekanizma më efikase për zbatimin e tyre**. Shumë të anketuar konsiderojnë se pa pasoja dhe përkufizime të qarta ligjore, përpjekjet për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar autorët mbeten të pamjaftueshme. Kjo duhet të shkojë dorë për dore me **koordinimin e përmirësuar institucional**, në mënyrë që të gjithë aktorët relevantë - nga organet e zbatimit të ligjit e deri te shërbimet sociale - të veprojnë në një mënyrë të koordinuar dhe efikase.

Shtyllë kryesore e reagimit është **ngritja e kapaciteteve**. Palët e interesuara e theksuan nevojën për **trajnim i specializuar për profesionistët e vijës së parë**, duke përfshirë psikologët, punonjësit socialë, edukatorët, zyrtarët policorë dhe prokurorët. Këto trajnime / **mentorime** duhet të përfshijnë një qasje që e merr parasysh traumën, dinamikën specifike të dhunës digjitale dhe qasjet e ndjeshme ndaj viktimave në rastet e raportimit dhe mbështetjes. Ekziston një nevojë e qartë për të **ndarë mjete të dedikuara** në kuadër të institucioneve, veçanërisht për t'u mundësuar psikologëve të përqendrohen në punën terapeutike në vend të detyrave administrative. **Programi i mentorimit (coaching)** mund të jetë një shtyllë themelore. Për të maksimizuar ndikimin e tij, trajnimi nuk duhet të përfshijë vetëm prezantimin e informatave, por edhe të përdorë **metoda eksperimentale** siç janë **lojërat me role, simulimi i rasteve reale dhe zhvillim i diskutimeve** duke u bazuar në dëshmi të anonimizuara. Këto metoda e inkurajojnë empatinë dhe përvetësimin e informacionit dhe mund t'i aftësojnë pjesëmarrësit të reagojnë në mënyrë më efikase në situata të jetës reale. Në mënyrë të ngjashme, ndërhyrjet në shkollë nuk duhet të përfshijnë vetëm teorinë. Për të rinjtë, veçanërisht ata që tashmë janë futur thellësisht në hapësirat digjitale, **aftësitë praktike për sigurinë digjitale janë thelbësore**. Sesionet mund të përfshijnë mënyrën e raportimit të abuzimit në platforma si Instagram ose TikTok, kuptimin e cilësimeve të privatësisë së të dhënave dhe njohjen e sjelljes manipuluese online. Këto mjete të prekshme, të ofruara në një gjuhë të lehtë dhe të kuptueshme, do të kenë një ndikim më të thellë sesa mesazhet e përgjithshme për ngritjen e vetëdijes.

Propozim për përgatitjen e dokumentit për politika: **“Hartimi i një programi mentorimi (coaching) për dhunën kibernetike me bazë gjinore”** i synuar për aktivistët e shoqërisë civile,

ekspertët juridikë, psikologët dhe ekspertët e sigurisë digjitale, kërkon **një qasje të kombinuar, pjesëmarrëse dhe që e merr parasysh traumën**. Nevojitet një propozim i përshtatur që përfshin **metodologjitë e të mësuarit, strukturën dhe skenarë ilustrues** që janë në përputhje me ekosistemin e OJQ-ve, qëllimet e projektit tuaj dhe grupet e synuara.

Propozim për përgatitjen e dokumentit për politika: Përveç kësaj, **“Hartëzimi i hapave të qartë të referimit për mekanizmat e raportimit”** si dhe mjetet dhe mekanizmat për ankesë – (si në mënyrë vizuale ashtu edhe përmes materialeve të shtypura) - mund t'i fuqizojnë nxënësit dhe punonjësit e institucioneve për të zbatuar një plan konkret veprimi. Kjo do të ndihmojë në ndryshimin e narrativit nga “kjo është dhunë kibernetike” në “kjo është ajo që mund ta bëjmë për ta trajtuar atë”.

Një tjetër propozim për përgatitjen e dokumentit për politika: **“Paralajmërimi i hershëm, mbrojtje e hershme:” Hartëzimi i treguesve dhe mjeteve për identifikimin e hershëm të viktimave të dhunës kibernetike me bazë gjinore**

Ky propozim i shkurtër për politikë do ta shqyrtojë nevojën urgjente për zhvillimin dhe institucionalizimin e një sërë **treguesish për identifikim të hershëm dhe mjete praktike për vlerësim paraprak (skrining)** për të identifikuar individët - veçanërisht gratë dhe të rinjtë - të cilët janë në rrezik ose tashmë përjetojnë dhunë kibernetike me bazë gjinore.

Ky propozim për dokument për politikë do të ofrojë rekomandime praktike për profesionistët e vijës së parë të mbështetjes (p.sh., edukatorët, punonjësit socialë, punonjësit me të rinjtë dhe praktikuesit nga organizatat e shoqërisë civile) dhe do të propozojë metoda dhe mjete për **zbulimin dhe ndërhyrjen e hershme**, duke u përputhur me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të qasjes që e merr parasysh traumën.

Mbështetja për viktimat duhet të jetë si e **qasshme ashtu edhe afatgjatë**. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit rekomanduan zgjerimin e qasjes në **ndihmë psikologjike dhe juridike falas ose të subvencionuar**, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Analizat e fizibilitetit për krijimin e **qendrave lokale dhe të lëvizshme të mbështetjes**, veçanërisht në komunitetet e pashërbyera, do të rrisnin ndjeshëm shtrirjen dhe reagimin ndaj këtyre shërbimeve. Paralelisht me këtë, zhvillimi i **mekanizmave të besueshëm dhe të lehtë për t'u përdorur**, si dhe promovimi i **grupeve të mbështetjes nga bashkëmoshatarët dhe platformave të terapisë online**, konsiderohen mjete kyçe për fuqizimin e viktimave dhe tejkalimin e izolimit.

Arsimi u shfaqur si një fushë tjetër kyçe për ndryshime sistemike. Ekziston një pajtim i gjerë se **edukimi digjital dhe vetëdijesimi për dhunën kibernetike duhet të përfshihen në plan-programet mësimore** që në moshë të hershme. Përveç arsimit formal, profesionistët e theksojnë nevojën për **fushatat për ngritjen vetëdijesimit publik**, të dedikuara për prindërit, mësimdhënësit dhe të rinjtë, me qëllim që ta njohin dhunën kibernetike dhe t'i kuptojnë pasojat e saj psikologjike dhe ligjore. Gjithashtu, programet duhet të përfshijnë **të mësuarit nga bashkëmoshatarët, mentorimin dhe edukimin përmes gamifikimit**, të cilat janë veçanërisht efektive në angazhimin e të rinjve. Kudo që të jetë e mundur, është e nevojshme të integrohet **tregim i storjeve**, si në politika ashtu edhe në përmbajtjen e fushatave për ngritjen e vetëdijes. Hartimi i një mjeti të bazuar në inteligjencën artificiale në formën e një asistenti digjital ose shërbimi këshillimor për dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë edhe dhunën kibernetike, i cili

mund të pilotohet në një faqe interneti ose aplikacion, duke i mundësuar grupit të synuar të parashtojë pyetje në lidhje me dhunën kibernetike me bazë gjinore, me ç'rast inteligjenca artificiale do të përgjigjej duke u bazuar në statistika, praktikën gjyqësore dhe masat mbrojtëse. Mjeti mund t'i udhëzojë përdoruesit drejt procedurave dhe masave përkatëse mbrojtëse.

Kjo sinergji duhet të zgjerohet duke e shqyrtuar mundësinë që programi i zhvilluar i mentorimit të mund të **institucionalizohet në kuadër të sistemeve kombëtare të arsimit ose sistemeve të trajnimit të punonjësve socialë**. Një integrim i tillë do të sigurote qëndrueshmëri dhe ndikim që do të zgjasin edhe pas përfundimit të projektit.

Platforma për mbështetje në kuadër të “Youth Counter” është një tjetër zhvillim premtues. Duhet të mendohet që dizajnimi i saj të bëhet në mënyrë të tillë që të mund të ripërdoret. Një “paketë mjetesh” e standardizuar që e përshkruan strukturën, shërbimet dhe proceset e saj do t'u mundësonte organizatave të shoqërisë civile – në nivel rajonal ose kombëtar – ta përshtatin modelin në komunitetet e tyre. Në këtë mënyrë, do të shumëfishohej ndikimi pa pasur nevojë të fillohet nga e para në vende të reja.

Në fund, një përgjigje e fortë dhe efektive ndaj dhunës kibernetike kërkon **bashkëpunim të gjerë ndërsektorial**. Pjesëmarrësit mbështetën krijimin e **partneriteteve me shumë palë të interesuara** duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, institucionet shtetërore, platformat teknologjike, shkollat dhe mediat. Këto partneritete duhet të bazohen në qëllime të përbashkëta dhe strategji të koordinuara. Përveç kësaj, profesionistët e theksojnë rëndësinë e **përfshirjes së të rinjve dhe të mbijetuarve të dhunës online në hartimin dhe zbatimin e programeve**, në mënyrë që politikat dhe ndërhyrjet të bazohen në përvojat dhe nevojat e jetës reale. Në një nivel më të gjerë, duhet të inkurajohet **shkëmbimi rajonal dhe ndërkombëtar i njohurive dhe praktikave më të mira**, për të pasuruar përpjekjet lokale dhe për të nxitur inovacionin.

Si përfundim, rekomandimet tregojnë qartë se përballja me dhunën kibernetike me bazë gjinore nuk është vetëm një çështje ligjore ose teknike - është një përgjegjësi shoqërore. Nevojitet një qasje e koordinuar, investime të qëndrueshme dhe, mbi të gjitha, një qasje e përqendruar te viktima që i jep përparësi shërimit, fuqizimit dhe drejtësisë.

Referencat

1. B.I.R.D. (2022). Share Monitoring; Ndjekja e Shkeljeve Digjitale në Evropën Jugore dhe Lindore.
2. Këshilli i Evropës. (2001). Konventa për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit). Marrë nga <https://rm.coe.int/1680081561>
3. Këshilli i Evropës. (2011). Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Marrë nga <https://rm.coe.int/168046031c>
4. Këshilli i Evropës. (2019). Rekomandimi CM/Rec(2019)1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi parandalimin dhe luftimin e seksizmit.
5. Këshilli i Bashkimit Evropian. (2024). Direktiva (BE)2024/1385 për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Parlamenti Evropian
6. Di Meco, L. dhe (2020). Dezinformimi me bazë gjinore është një problem i sigurisë kombëtare. Marrë nga <https://www.brookings.edu/articles/gendered-disinformation-is-a-national-security-problem/>
7. EIGE. (2021). Luftimi i Dhunës Kibernetike ndaj Grave dhe Vajzave, EIGE - Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Marrë nga <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/combating-cyber-violence-against-women-and-girls>
8. GREVIO. (2021). Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 1 për dimensionin digjital të dhunës ndaj grave. Marrë nga <https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147>
9. ICRW, Hinson L, Mueller J, O'Brien-Milne L, Wandera N. (2018). Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) e lehtësuar nga teknologjia: Çfarë është dhe si ta matim? Marrë nga <https://www.icrw.org/publications/technology-facilitated-gender-based-violence-what-is-it-and-how-do-we-measure-it/>
10. ITU. (2024). Gjendja e internetit me brez të gjerë në vitin 2024: Përdorimi i Inteligjencës Artificiale për Lidhje Universale, Komisioni për Internetin me Brez të Gjerë. Marrë nga <https://www.broadbandcommission.org/publication/state-of-broadband-2024/>
11. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2022). Strategjia për Barazi Gjinore 2022- 2027.
12. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2021). Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje.
13. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2023). Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut
14. OSBE, Bojana Jovanovska. (2022). Nga normalizimi në vetëcensurë – Analizë e ngacmimeve online ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut. Marrë nga <https://www.osce.org/files/f/documents/b/e/526985.pdf>
15. Llojet e dhunës kibernetike, Këshilli i Evropës. (pa datë). Llojet e dhunës kibernetike. Marrë nga <https://www.coe.int/en/web/cyberviolence/types-of-cyberviolence>
16. UN WOMEN. (2023). PËRSHPEJTIMI I PËRPIEKJEVE PËR TË ADRESUAR DHUNËN ONLINE DHE DHUNËN E LEHTËSUAR NGA TEKNOLOGJIA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE. Marrë nga https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-10/Accelerating-efforts-to-tackle-online-and-technology-facilitated-violence-against-women-and-girls-en_0.pdf
17. UN Women. (2023). ANA E ERRËT E DIGJITALIZIMIT: Dhuna ndaj grave e lehtësuar nga teknologjia në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Marrë nga https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2024-01/research-tf-vaw_full-report_24-january2.pdf
18. UNESCO. (2023). “Zbulimi i dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia në epokën e inteligjencës artificiale gjeneruese.” Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000387483>